

Lexuesit dhe blerësit e librit në libraritë e Prishtinës janë më shumë të interesuar për letërsinë e përbotshme, të përkthyer në gjuhën shqipe. Por ka edhe shumë blerës që kërkojnë libra vetëm në gjuhën angleze. Ky është një trend në Prishtinë. Librarët mund ta shpjegojnë më mirë psenë e këtij trendi. Për dallim prej Tiranës, lexuesit dhe blerësit e librave në libraritë e Prishtinës janë më pak të interesuar për letërsinë shqipe.

Mungon klima miqësore mes krijuesve të Tiranës dhe të Prishtinës

Dialog letrar me shkrimtarët
VIRION GRAÇI
ADIL OLLURI

Takimi i shkrimtarëve të Diasporës

GJITHMONË DREJT SHTËPISË nga Mimoza Hysa

Çfarë mund t'i bëjë bashkë njerëzit e letrave? Çfarë mund t'i mbledhë në një kuvend? A mund të ketë një tubim ekstra-letrar që i bashkon ata? Përtej hapësirës së lirisë së shkrimit, a mund të ketë një hapësirë ku mund të rrihen mendime, të hidhen ide dhe të gjykohe mbi gjithçka ka të bëjë me fushën e letrave, me situatën e shkrimtarëve dhe përkthyesve...

OMBRA GVG boton librin e shkrimtarit të mirënjohur maltez

"JUTA HAJM"

nga Immanuel Mifsud

(fq. 10)

Me rastin e 120 vjetorit të lindjes

NJË KUJTIM I PAHARRUAR ME SEJFULLA MALËSHOVËN

nga Xhafer KORRO

(fq. 12)

Fragment nga libri që u promovua
të enjten në Librarinë Onufri

AURA KRIPTO- TEOLOGJIKE E TRUPIT POLITIK

nga Gëzim Qëndro

(fq. 13)

IMAZHE TË SHQIPTARËVE PËRMES AUTORËVE TË SHQUAR TË LETËRSISË BOTËRORE

(Chateaubriand • Byron • Winther • Shelley • Hugo • Dumas
Tennyson • Pirandelo • Amicis ...)

nga Prof. Dr. Ferid Hudhri

(fq. 6)

SHPALLET LISTA E GJATË E ÇMIMIT LETRAR "MAN BOOKER PRIZE INTERNATIONAL 2020"



SHIJE TË NDRYSHME NË LETËRSI

nga C.S. Lewis

(fq. 14)

SHËN SHIU

cikël poetik nga

Elida Buçpapaj



HISTORI PA BIOGRAFI

ese nga

Rexhep Ferri



BIBLA

tregim nga

Uran Butka

Lexuesit dhe blerësit e librit në libraritë e Prishtinës janë më shumë të interesuar për letërsinë e përbotshme, të përkthyer në gjuhën shqipe. Por ka edhe shumë blerës që kërkojnë libra vetëm në gjuhën angleze. Ky është një trend në Prishtinë. Librarët mund ta shpjegojnë më mirë psenë e këtij trendi. Për dallim prej Tiranës, lexuesit dhe blerësit e librave në libraritë e Prishtinës janë më pak të interesuar për letërsinë shqipe.

Dialog letrar me shkrimtarët VIRION GRAÇI ADIL OLLURI

Mungon klima miqësore mes krijuesve të Tiranës dhe të Prishtinës

V. Graçi: Përhëndetje, Adil! U bë gati një vit që nuk kam qenë në Prishtinë. Si duket Prishtina dhe Kosova këto kohë në sytë tuaj?

A. Olluri: I dashur Virion, i gëzohem miqësisë letrare me secilin shkrimtar të Shqipërisë. Miqësinë me ju e vlerësoj, gjithashtu, si një nga gjërat më të mira që më ka ndodhur. Në këtë kohë, kur politika po e largon çdo ditë e më shumë Prishtinën nga Tirana, shkrimtarët e të dyja anëve është e udhës që të krijojnë sa më shumë miqësi letrare e ura bashkëveprimi.

Prishtina në këtë kohë është në vllugun e zhvillimeve të mëdha politike dhe pakkush interesohet për letërsinë. Njerëzit këtu kanë një besim dhe një shpresë te qeveria e re dhe kryeministri i ri. Unë gjithnjë kam rezervat e mia për këtë qeveri, sikurse për qeveritë e kaluara. Dyshoj në seriozitetin dhe sinqeritetin e politikanëve. Shtetarët duhet të punojnë dhe të shpalosin projekte konkrete për zhvillimin e vendit, e jo të ngjizin shpresë dhe besim te qytetarët. Shpresë dhe besim ofrojnë vetëm religjionet, funksionarët e shtetit do të duhej të ofronin diçka tjetër. E nga Tirana?

V. Graçi: Kënde kemi një tablo të fjetur. Nuk ka ndodhur së afërmi ndonjë rotacion në kupolën politike, kështu që asgjë e re nga piramida shtetërore dhe politikat e saj. Ndërkohë shkrimtarët, botuesit, gazetarët, secili në mënyrën e vet dhe për llogarinë e vet, përpiqen ta mbajnë ndezur dritën e interesit dhe shpresën për kulturë, letërsi, jetë krijuese e debatuese. Gjithsesi, tingëllon si fatalitet të merresh me krijimtari letrare. Shpesh ka shkrimtarë të shpikur nga mediat e grupazhet, tek-tuk ka zbulime me vlerë. Ju, për shembull, jeni nga romancierët dhe tregimtarët e rinj që keni tërhequr vëmendjen e njerëzve të kualifikuar që i ndjekin zhvillimet letrare në hapësirat ku shkruhet shqip. E keni ndier këtë interes? Ç'do të thotë të jesh shkrimtar i ri në Kosovë?

A. Olluri: Të merresh me një veprimtari, siç është krijimi letrar, interesimi për të cilin dita-ditës po venitet në mbarë botën, është si një lloj vetëflirimi i dëshiruar e i dëshirueshëm për hir të një pasioni fisnik.

Ndërsa, të jesh shkrimtar, veçmas i ri, në një vend të vogël e të varfër dhe me një kulturë të varfër leximi, siç është Kosova, është sikur të përpiqesh ta gjeshe gjilpërën në një dhomë të errët e të pandriçuar. Ti je thuajse i bindur se gjilpërën nuk mund ta gjeshe, por vazhdon ta kërkojë. Nuk resht së kërkuari. Ky është pasioni, i dashur mik. Njerëzit e kualifikuar, si në Prishtinë, po ashtu në Tiranë, jo rrallëherë ia fusin kot, dhe ju e dini mirë këtë. Mua më mban gjallë vetëm kërkimi i “gjilpërës” dhe asgjë tjetër. Ju mund të keni përvojë më të gjatë zhgënjimesh e gëzimesh letrare, apo jo?

V. Graçi: Po. Mirë e thatë. Këto kohë, meqë kam pasur dy botime që kanë rënë në sy të lexuesve, por jo të përzgjedhësve të autorizuar burokratë, më kanë pyetur me shaka miq të ndryshëm se si ndihem. Do të vazhdoj të shkruaj edhe sikur të ndëshkohem për ato që shkruaj e botoj, kam thënë. Natyrisht që shkrimtaria ndër shqiptarë është si harakiri për autorin, por shpëtim shpirti për atë vetë dhe gjeneratën e tij. Pararendësit tanë kanë shkruar e kanë jetuar në kushte ku e ku më të papërshtatshme se ne. A nuk më

thoni: Cila është marrëdhënia e shoqërisë shqiptare në Kosovë me librin? I frekuentojnë libraritë? Bibliotekat? Cilat janë zhanret letrare më me popullaritet në Kosovë?

A. Olluri: Në Prishtinën time të dashur, me gati gjysmë milion banorë, ka nevojë për sa më shumë kënde të librit. Ka nevojë për sa më shumë kënde ku promovohet leximi i librit, letërsisë së bukur, sidomos i letërsisë shqipe. Promovuesit e leximit të librit dhe letërsisë shqipe sot janë patriotë në kuptimin sublim të fjalës. Një shoqëri që lexon, gjithsesi, edhe mendon më shumë. Një shoqëri që lexon, gjithsesi, edhe reagon, revoltohet dhe indinohet kur sheh padrejtësi dhe dëgjon të pavërteta.

Aq sa kam mundur të vërej, i dashur Virion, lexuesit dhe blerësit e librit në libraritë e Prishtinës janë më shumë të interesuar për letërsinë e përbotshme, të përkthyer në gjuhën shqipe. Por ka edhe shumë blerës që kërkojnë libra vetëm në gjuhën angleze. Ky është një trend në Prishtinë. Librarët mund ta shpjegojnë më mirë psenë e këtij trendi. Për dallim prej Tiranës, lexuesit dhe blerësit e librave në libraritë e Prishtinës janë më pak të interesuar për letërsinë shqipe. Ndërkaq, në bibliotekat në Prishtinë dhe qytetet e tjera të Kosovës ka fare pak lexues që lexojnë vepra jashtë planifikimeve të tyre shkollore e akademike. Shumica e frekuentuesve të bibliotekave kosovare janë studentë që lexojnë për t'u përgatitur për provimet e tyre, por mund të gjeshe edhe njerëz të profileve akademike që i vizitojnë bibliotekat për shkak të projekteve të tyre shkencore. Zhanri më i kërkuar nga lexuesit kosovarë, sikurse edhe në çdo vend tjetër të Europës, është, pa dyshim, romani.

V. Graçi: Edhe këtu e kemi këtë simptomë snobizmi provincial që konvertohet në shfaqjet publike si pseudointeres për çdo gjë që nuk është shqip e nuk është shqiptare. Deri aty arrin entuziazmi i shtirur i spitullaqëve tanë mediatikë, sa autorë të dorës së tretë që janë thëngjij të fikur në vendet e tyre këtu e gjysmë shekulli përpara, të paktën, këtu po i zbulojnë dhe po i ofrojnë më zhurmë si letërsi e madhe bashkëkohore. Kanë frikë e smirë njëkohësisht ta njohin veten, vendin tonë, nëpërmjet shprehjeve përkatëse letrare, cilatdo qofshin ato. Pra, njerëz bosh, kozmopolitizëm provincial. Por, në këtë mes, kritika mund të luante një rol përmirësues. Kritika letrare-shkencore në Kosovë në kohën e totalitarizmit ideologjik shtetëror ka qenë më e lirë në pikëpamje metodologjike se ajo këndeje kufirit. Kam bindjen si një brez i ri studiuesish po e vijon atë traditë. Cili është roli dhe prania juaj në mjedisin kulturor në Kosovë? A jeni mjaftueshëm të pranishëm? Ndikues?

A. Olluri: Është e vërtetë që kritika letrare në Kosovë nuk ka qenë e shtrënguar nga totalitarizmi ideologjik, sikurse ishte në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit XX. Por kritika letrare në Kosovë nuk mund të themi se ishte e liruar nga tentimet e pareshtura për t'i zhvlerësuar një grup shkrimtarësh në favor të një grupi tjetër, që parapëlqeheshin nga studiuesit dhe establishmenti kulturor i kohës. Unë çdo ditë e më shumë habitem se si janë lënë në harresë shkrimtarë të vlerave të epërme letrare dhe janë promovuar e janë trajtuar me respekt shkrimtarë që do të duhej ta meritonin harresën. Është e dhimbshme ta them, por një brez i ri studiuesish po e vijon këtë traditë. Ju vetë a jeni i kënaqur me mënyrën si kritika në Shqipëri e ka shoqëruar krijimtarinë tuaj gati 30-vjeçare?

V. Graçi: Më kapët ngushtë. Sivjet bëhen 25 vjet nga botimi i romanit tim të parë, i suksesshëm në Shqipëri e jashtë saj, por për



atë libër 25 fjalë nuk janë shqiptuar në këta 25 vjet, jo doemos fjalë lavdëruese, por në nivel të fakteve letrare-kulturore... Janë pastaj 10-12 romane nëpër këto dekada dhe e njëjta histori heshtuese. Në përgjithësi, kritika këndej e ka humbur ndikimin, autoritetin, seriozitetin dhe për këto arsye është më mirë të mos të të trajtojë. Shkrimet vlejnë sa për kënaqësi të vogla vetjake, familjare, miqësore e asnjë çap më tej. E kjo është alarmante. Por le të qëndrojmë te fillimet: Kur e mendove veten shkrimtar? Sprovat e para. Autorët të cilët të kanë ndihmuar të biesh në dashuri me letërsinë?

A. Olluri: I dashur mik, do t'ju gënjeja po t'ju thosha se dashuria për letërsi dhe ëndrra ime për t'u bërë shkrimtar më ka lindur që në fëmijëri. Mbjaj mend që kur isha njomak dhjetëvjeçar ëndërroja të bëhesha futbollist dhe të luaja për kombëtaren e Italisë. Një ëndërr e çuditshme fëmijërie. E arsyeshme për moshën. Kosova nuk kishte atëherë kombëtare, Shqipëria luante dobët, andaj ëndrrat e një fëmije identifikohen me heronjtë, në rastin tim me ata që luanin bukur. Kur isha në shkollë të mesme, synoja të bëhesha mjek. Njeriu që më shtyu të mendoja intensivisht për letërsinë ishte Fahri Hysaj, profesor i regjisë së filmit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, por që jetonte në qytezën e vogël të Shtimës, aty ku e kreu shkollën e mesme. Ai më sillte vepra të rëndësishme nga letërsia botërore dhe ajo shqipe; pasi i lexoja, i komentoja para tij. Nuk ma jepte librin e radhës po qe se nuk e lexoja librin që ma kishte dhuruar. Nuk dua t'i përmend me emër autorët dhe titujt e veprave që m'i ka dhuruar, por gjatë vitit të tretë dhe të katërt të shkollës së mesme, me sugjerimin dhe dhurimin e tij, i kam lexuar më të rëndësishmit e letërsisë shqipe dhe asaj të përbotshme. Fahri Hysaj është "fajtor" që unë mora rrugën e letërsisë. Një takim, një njohje, mund të ta ndryshojë rrjedhën jetësore. Po të mos takohesha e të mos njihesha me të, nuk jam i sigurt nëse do të bëhesha shkrimtar. Ai e "krijoi" një shkrimtar dhe po të ishte gjallë, jam i sigurt se do të ndihej fajtor, për shkak se ishte thellësisht i bindur se rruga e një artisti dhe synimi për ta ruajtur fisnikërinë e artit ishte më shumë se e mundimshme. Kurse ju jeni diçka përpara meje në moshë, në përvojë...

V. Graçi: Relativisht vonë kam filluar të shkruaj letërsi artistike. Duhet të kem qenë student në vitin e parë/ dytë kur shkrova një numër të madh poezish. Nga ato poezi ka mbetur e ashtuquajtura trashëgimia ime poetike. Mendoja se për çdo gjendje njerëzore ishin shkruar më herët librat e duhur e më duhej



vetëm të kërkoja nëpër librari dhe jo t'i bëja vetë librat që më duheshin, më plotësonin, më përfaqësonin. Nga viti 1990 fillova të mbushesha me historitë e mia dhe guxova t'i hedh në letër pa pyetur për çast të papërshtatshëm, as për modele suksesi. Ashtu si më vinte jeta ime, ashtu si e përjetoja spektaklin epik qark meje – ishte e fuqishme, e pasur vetiu me tipa, karaktere, të cilat prisnin me padurim radhën për të marrë jetë letrare në skenën time shkrimore. Pa e shkruar një tregim e prozë të shkurtër, e shkrova më një frymë romanin tim të parë. Dhe pa u menduar gjatë kërkoja botues, e botova, në moshë fare të re. Një roman më vete janë kujtimet e asaj sprove të mbarë. Juve çfarë ju kujtohet nga vendimi për ta botuar librin e parë? A kanë ndryshuar ndërkohë pritshmëritë tuaja në lidhje me botuesit, kritikën, lexuesit në përgjithësi?

A. Olluri: Nuk mund të them se kisha frikë ta botoja librin e parë. Më shumë frikësohesha se si do të pritej nga njerëzit që i njihja e që nuk i njihja. Kam menduar se këtë frikë e kisha ngaqë ishte libri i parë. Por, jo. Të njëjtën ndjesi e kisha dhe e kam me secilin botim dhe ribotim të librave të mi. Në çastin që libri del nga shtypi, aty fillon përballja me syrin dhe mendjen e tjetrit. Kjo, pa dyshim, është frikësuese. Me botuesit gjithnjë kam pasur marrëdhënie të mira. Ruaj raporte të mira me ta. Kritika letrare shqiptare shpeshherë di të jetë dinake. Rrallëherë është e njëmendtë. Kur e pata botuar librin e parë me tregime, më entuziazmonte secili mendim i mirë dhe më shqetësonte secili mendim jo i mirë. Tash e marr më shtruar, më ftohtë, gjithnjë duke pasur parasysh se secili interpretim a secila analizë e një veprë është thjesht një opinion i veçantë në shumën e përgjithshme të opinionëve për një vepër a për një autor. Për mendimin tim, vlera ose jovlera e një veprë apo autori nuk nxirret nga një analizë "e saktë" dhe "shkencore" e një njohësi eminent të letërsisë, por është shuma e mendimeve dhe opinionëve që e përcaktojnë atë. Ne jemi të bindur se filan shkrimtar e filan vepër është e arrirë në planin artistik, jo pse atë na ka dhënë saktësisht analiza e filan njohësi eminent të zhvillimeve letrare, por për shkak të shumës së mendimeve kualitative që bëhen rreth veprës/ autorit. Ta zëmë, ne jemi të bindur se Dostojevski është autor i vlershëm e i rëndësishëm, jo pse këtë na e tha një kritik autoritativ, por për shkak të asaj që e thashë më sipër. Jam për demonopolizimin e mendimeve për letërsinë e bukur. Ç'do të ndodhte, i dashur mik, po qe se vetëm akademitë e Tiranës dhe Prishtinës apo katedrat dhe departamentet e letërsisë në të dyja anët do ta kishin monopolin e vlerësimit të letërsisë. Do ta dëmtonin letërsinë, do ta zhbënin konkurrencën e mirëfilltë të vlerave, duke krijuar


vetëm koniunktura e elita të paqena shkrimtarësh. Ajo nuk do të ishte kritikë letrare, por agjenturë letrare, që do të ishte më shumë se e dëmshme. Monopoli në një vepërtari humane sjell vetëm regres, asgjë më shumë.

V. Graçi: Pajtohem me mendimin tuaj se duhet të shkruajmë e të mendojmë më tepër për kënaqësinë e leximit të teksteve tona nga lexuesit; vetëm nëpërmjet tyre letërsia qëndron në jetë. Asnjë kritikë e argumentuar teorikisht nuk mund ta mbajë në jetë një letërsi boshe, pa frymë, pa fizionomi, sikurse, nga ana tjetër, as censura më e keqe mohuese, izoluese, nuk mund ta asgjësojë një vepër letrare me vlera, me fuqi artistike, me origjinalitet.

A. Olluri: Pikërisht.

V. Graçi: Mund të di diçka më shumë për tregimet tuaja? Jeni botuar si tregimtar në disa gjuhë europiane. Si e ndieni veten kur shkruani një histori të shkurtër (tregim) dhe një histori të gjatë (roman)?

A. Olluri: Tregimet e mia janë përkthyer dhe janë botuar në disa gjuhë europiane. Secili botim ndërkombëtar, qoftë si libër më vete, qoftë si botim i



një tregimi në ndonjë revistë, më ka gëzuar. Ndoshta, mund të dukem paksa patetik, por më mirë ndihem kur botohem në Prishtinë dhe Tiranë. Në këto dy kryeqendra shqiptare e ndiej veten të plotë. Unë i përkas kësaj kulture dhe natyrisht, këtu dua të shprehem, të flas e të shquhem si krijues. Jam ithtar i mendimit se shkrimtarët e mirë, së pari, duhet të shquhen dhe të pranohen nga vendi i tyre, lexuesi dhe kultura e tyre amtare, pastaj të pëlqehen nga bota. Unë historitë e shkurtra (tregimet) dhe historitë e gjata (romanet) i shkruaj për lexuesit shqiptarë. Kur nuk lexohem dhe nuk pranohem prej tyre, atëherë nuk do të më përmbushte as përkthimi e depërtimi, sado i suksesshëm, ndërkombëtar.

Kur e shkruaj një tregim apo kur nis ta shkruaj një roman, ndiej një tirani të tmerrshme të shkronjave e të mendimeve që më robëron për një kohë të gjatë. Krijimi është e vetmja gjë që më robëron dhe nuk kam dëshirë të bëj gjë tjetër. E ndiej të nevojshme vetminë dhe lutem të mos më thërrasë askush për kafe. Gjatë procesit të krijimit do të dëshiroja që dita t'i kishte, së paku, njëqind orë. Krijimi është e vetmja veprimtari imja që i bëj vetes presion. Gjërat e tjera i marr më me sportivitet.

V. Graçi: A është në marrëdhënie normale klima letrare sot në Prishtinë dhe Tiranë? Çfarë mund të mësojë njëra anë nga tjetra? Çfarë mund të përmirësojmë për të zgjeruar kufijtë tanë të shprehjes si shkrimtarë në editori? Në shpërndarje?

A. Olluri: Siç e thashë edhe në fillim të kësaj bisede, është mirë të krijohet një klimë sa më miqësore mes krijuesve të Tiranës dhe Prishtinës. Duhet të krijohen hallkat e një bashkëveprimi sa më dinjitoz. Të ketë më shumë aktivitete e takime të përbashkëta letrare. Duhet të krijojmë një klimë të një afërsie normale, në mënyrë që një krijues i Prishtinës ta ndiejë veten se i takon edhe Gjirokastrës dhe Fierit, e assesi të mos i duken si dy qytete të një vendi tjetër; njashtu edhe një shkrimtar i Tiranës ta ndiejë veten se i takon edhe lexuesit që mund të jetë në Ferizaj, Tetovë e Gjilan. Ky është bashkimi ynë letrar. Nuk kemi rrugë tjetër. Ata që na shohin e na mendojnë vetëm si shkrimtarë

të dy vendeve të ndryshme, janë vetëm të zhytur e të vetëmjaftuar me moçalishten e tyre provinciale. Ju jetoni dhe punoni në Tiranë. A është i admirueshëm për një shkrimtar fakti i të qenit banor i kryeqendrës kulturore shqiptare apo është njësoj sikur të banonte të Shkodër, Fier, Vlorë etj.? Ta zëmë në Kosovë, një shkrimtar shqiptar që jeton, p.sh., në Ferizaj a Gjilan, e jo në Prishtinë, është gjithsesi më larg mediave, botuesve, emisioneve televizive të kulturës dhe mënyrave të tjera të promovimit të veprës së tij.

V. Graçi: Në mënyrë të merituar a të ekzagjeruar, Tirana vazhdon të mendohet si maja e një piramide të dyfishtë, si për Shqipërinë ashtu edhe për Kosovën dhe trojet e tjera shqiptare. Me mjetet e sotme të komunikimit, pak rëndësi luan adresa e banimit apo vendndodhja e shkrimtarit. Kryeqyteti duhet për ata që duan të jenë fizikisht nëpër sfilada të ndryshme mondane, përfshi edhe ato me pretendime letrare. Sikurse u shpreha me rezerva për mrekullitë që mund të bëjë kritika në të mirë a në dëm të shkrimtarit, të njëjtën gjë mund të them edhe për kryeqytetin. Dinjiteti i shkrimtarit është në trekëndëshin vepër-botues-librari. Këtu duhet të jemi të pranishëm e pretendues, njëkohësisht.


A. Olluri: Jeni një nga romancierët më të lexuar dhe të vlerësuar të letërsisë së sotme shqipe. Ç'thote për ju ky fakt? A e ndieni se lexuesi shqiptar ua ka dhënë atë që keni merituar apo jeni të bindur se vepra juaj duhet të lexohet dhe të vlerësohet më shumë e më thellë?

V. Graçi: Jemi qenie tekanjoze, egoiste, besoj, mbi mesataren e zakonshme. Nga njëra anë, na pëlqen të jemi mbizotërues, në qendër të vëmendjes; nga ana tjetër, poza jonë më e natyrshme është e duhet të jetë modestia, vetëviktimizimi, përvujtnia e ekzagjeruar. Besoj se njihem mjaftueshëm, në përpjesëtim të drejtë me aq sa meritoj e kam nevojë të njihem si njeri. Kurse për romanet, nisur nga shifrat, reagimet e ndryshme kanë bërë vend në bibliotekat e lexuesve pa u vjetruar. Poezinë ma kanë pëlqyer edhe më shumë, e mbase me një lloj xhelozie prindërore, atë po e ruaj ende si pronë private, nuk e shpërndaj.

A. Olluri: A mendoni se letërsia aktuale shqipe lexohet mjaftueshëm në Tiranë apo duhet ende punë e promovim për ta bindur lexuesin tiranas që në libraritë kryeqytetase t'i zgjedhë dhe t'i blejë veprat e shkrimtarëve të tashëm shqiptarë?

V. Graçi: E cekëm më herët, lexohet, por jo sa duhet. E për më keq, promovohet zakonisht letërsia më e dobët dhe autorët më pa cilësi. Përse ndodh kështu? Sepse autorët e mirë pak shprehi praktike mund të kenë ta menaxhojnë veprën e tyre si një send për publikun. Dhe për arsyt tjetër: disa e mendojnë skenën letrare si skenë cirku, ku me akrobaci teknologjike e klanore mund të bëhen padronë të saj. E këta e banalizojnë letërsinë në sytë e publikut. Fatkeqësisht, vetëm këtu e shoh me shqetësim etjen e tyre për protagonizëm publicitar.

A. Olluri: Krijues shqiptarë që jetojnë në Tiranë dhe qytetet e tjera shqiptare, me të cilët kam pasur rastin të njihem, e kanë thujse nevojë të domosdoshme të njihen, të lexohen dhe të vlerësohen nga kritika letrare shqiptare në Kosovë. A e ndieni edhe ju këtë nevojë për kritikët akademikë kosovarë, apo thjesht ju mjafton lexuesi shqiptar, si në Prishtinë, Tiranë, Gjakovë, Shkodër apo kudo qoftë ai?



V. Graçi: Është më se e domosdoshme të trajtohen e të përmenden shkrimtarët tanë dhe veprat e tyre jo vetëm nga kritika universitare-akademike, jo vetëm nga portalet kulturore, por nga të gjithë ata që japin letërsi e qytetërim shqiptar në shkolla, kolegje, fakultete, medime të ndryshme. Duhet respektuar e artikuluar puna e secilit, pavarësisht pëlqimeve intime si lexues. Pra, duhet krijuar e riplotësuar pareshtur tabloja e përgjithshme letrare me çdo prurje – kjo fillimisht në nivel informacioni. Mandej, sipas rëndësisë e meritave...

A. Olluri: A jeni mjaftueshëm i pranishëm në jetën kulturore e letrare tiranase?

V. Graçi: Brenda natyrës sime jo fort të hapur, në përgjithësi, nuk u kam bërë bisht veprimtarive letrare apo debateve parimore që janë në mundësitë e mia njohëse. Në fakt, marr më shumë ftesa sesa kam kohë e mundësi reale për t'u përgjigjur pozitivisht.

A. Olluri: A mendoni se duhet të ketë më shumë bashkëpunime e aktivitete të përbashkëta letrare mes krijuesve të Tiranës dhe Prishtinës?

V. Graçi: Pa diskutim. Kemi nevojë për njohje të mirëfillta njerëzore, për bashkëpunime e bashkërendime në botime e në promovim. Historia jo fort e largët na ka provuar sa me dobi kapitale ka qenë njohja e shkrimtarëve dhe studiuesve tanë me përfaqësues në të dyja anët e kufirit: romanet e Kadaresë në Kosovë, poezia e Podrimjes, Dedajt në Shqipëri, krahas kritikëve të respektuar nga Prishtina që kanë sjellë një frymë të re, vitale e moderne.

A. Olluri: Ç'plane ka shkrimtari Virion Graçi?

V. Graçi: Rrëmuje jam, i dashur Adil. Planet nuk më dalin kurrë, aq më pak parashikimet. Hë për hë po i lutem Zotit me mërmërimë të më kursejë prej gripit kinez. Më vonë mund t'i lutem me shkrim. E mbase prej saj mund të dalë ndonjë vepër komiko-tragjike.



GJITHMONË DREJT SHTËPISË

Mimoza HYSA
Drejtoresh e Qendrës së Botimeve për Diasporën

Çfarë mund t'i bëjë bashkë njerëzit e letrave? Çfarë mund t'i mbledhë në një kuvend? A mund të ketë një tubim ekstra-letrar që i bashkon ata? Përtej hapësirës së lirisë së shkrimit, a mund të ketë një hapësirë ku mund të rrihen mendime, të hidhen ide dhe të gjykohet mbi gjithçka ka të bëjë me fushën e letrave, me situatën e shkrimtarëve dhe përkthyesve, me gjendjen e letërsisë shqipe dhe nevojën e promovimit brenda e jashtë vendit, me të drejtat e autorit dhe mbështetjen e shtetit në këtë drejtim? Përvoja e hidhur e artit dhe letërsisë së angazhuar të realizimit socialist, “të inxhinierëve të shpirtit” “të lidhur” në Lidhje përbashkimi mendimi e idesh, i hedh dyshimet si hije të gjata edhe pas tri dekadash.

Të gjitha këto pyetje u shtruan kur Qendra e Botimeve për Diasporën që drejtoj mori përsipër, me nismën e Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, të organizojë një takim të shkrimtarëve të letërsisë shqipe që jetojnë jashtë vendit. Është e qartë që hapësira e shkrimit, siç e ka përcaktuar dhe Barth-i, është hapësira ku shkrimtari ushtron lirinë e tij të zgjedhjes, e kufizuar mes dy kllapash shtrënguese që janë gjuha dhe stili i tij. Kjo është hapësira e shenjtë individuale, në të cilën nuk kanë vend politikën dhe orientimet. Përtej saj, shkrimtari është një qenie sociale që jep ndihmesën e vet të rëndësishme në kulturën e një vendi dhe njëkohësisht ka nevojën e njohjes dhe vlerësimit të kontributit të tij.

Kuptuar kështu, Komuniteti Europian në “Statutin Social Europian” të miratuar më 7 qershor 2007, me qëllim nxitjen e formave të mbrojtjes së Artistit/Autorit, ftoi të gjitha vendet anëtare të hartonin Regjistrin Profesional Europian për “nxitjen e njohjes së përvojës profesionale të artistëve”, një lloj pasaporte europiane për artistët dhe shkrimtarët. E gjitha kjo për mbrojtjen e të drejtave të autorëve, shkrimtarëve dhe përkthyesve, për vëmendje më të shtuar ndaj veprës së tyre, për një promovim më të organizuar e më të mirë të librit dhe leximit, si dhe për të krijuar rrjete bashkëpunimi mes bibliotekave, instituteve të kulturës, shtëpive botuese, qendrave të librit, institucioneve shtetërore apo private që kanë në fokus librin e leximin.

Për të gjitha këto, për të diskutuar atë hapësirë lirie që është shkrimi, për një njohje më të mirë të veprës së gjithsecilit, për problematikat që shqetësojnë fushën e letrave, takimet marrin kuptim. Në përgjigje të pyetjeve të shtrëna, u hartua edhe agjenda e takimit të shkrimtarëve të letërsisë shqipe, me vëmendje ndaj të gjithë atyre që erdhën nga vende të ndryshme të botës. Dihet që historia jonë e letrave që në zanafillë ka njohur shkrimtarë që zgjedhin të shtegtojnë jashtë për shkollim a një njohje më të mirë të botës, për përvojë jete a nevojë mbijetese, ashtu siç ka njohur edhe shkrimtarë të dëbuar, të ashtuquajtur “të ekzilit”, shkrimtarë të ndaluar apo shkrimtarë të mërgatës, e pikërisht kësaj kategorie shkrimtarësh iu kushtua vëmendje, edhe pse të ftuar në diskutime kishte dhe shkrimtarë me banim në trevat shqiptare.

Në panelin e parë autorët Ardian Ndreca (Itali), Bashkim Shehu (Spanjë), Luan Topçiu (Rumani) e Rudolf Marku (Angli) në moderimin e Prof. Dr. Persida Asllani, diskutuan për temën: **“Revistat kulturore në diasporë”**. U nxor në pah roli i revistave kulturore si një nga kapitujt më interesantë e domethënës të historisë së kulturës shqiptare. Të lindura së pari në diasporë, por të ndjekura edhe nga simotrat e tyre brenda territorit të shtetit shqiptar, u diskutua rreth rolit që ato kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë si mediumi më cilësor i komunikimit tonë ndërkulturor. Secili nga të ftuarit, në vijueshmëri të traditës, paraqiti kontributin e tij përmes drejtimit të disa prej revistave më të rëndësishme jashtë

vendit: “Shejzat” nga Ardian Ndreca, “Albanica” nga Luan Topçiu, “Bridge” nga Bashkim Shehu, si dhe projekti më i ri i revistës letrare të Rudolf Markut. Përmes diskutimit u hodh dritë në panoramën bashkëkohore të këtij mediumi kulturor dhe u paraqitën mundësi të reja të mbështetjes dhe fuqizimit të këtij mediumi.

Në panelin e dytë autorët Anisa Markarian (Francë), Durim Taçi (Itali), Enkel Demi e Stefan Çapaliku në moderimin e gazetares Arta Marku, diskutuan rreth temës: **“Pluraliteti i kujtesave dhe letërsia”**. Çfarë përbën kujtesa në krijimtarinë e gjithsecilit? A përbën dallim këndvështrimi i ngjarjeve, i vendit, i atdheut kur shihet nga brenda, afër a larg? Në këtë panel u diskutua pikërisht për kujtesën vetjake të shkrimtarit si perceptim i pasqyruar në letërsi; për perceptimet vetjake e të paraardhësve; për përzgjedhjen në kujtesë të lëndës letrare; për njerëz, vende a ngjarje konkrete që qysh në kujtesë kanë nisur ta tejkalojnë realitetin; për të vërtetën letrare që, sado e “endur” në laboratorë krijesish, mund të jetë e vërteta me V të madhe. Tema e këtij paneli kishte të bënte me trajtimin e asaj hapësire lirie krijuese që përmendëm në krye të herës, duke shërbyer kështu për një njohje më të mirë të veprave të autorëve tanë.

Në panelin e tretë, me autorët Denata Ndreca (Itali), Griselda Doka (Itali), Ndue Ukaj (Kosovë) e Thanasi Medi (Greqi) të moderuar nga Alda Bardhyli, iu dha hapësirë leximeve autoriale e njohjes me krijimtarinë e autorëve të ftuar. Interesante ishte theksi që vuri Ndue Ukaj për gjetjen në të ardhmen të formave dhe mënyrave për mbështetjen e kulturës shqiptare, kuptuar ajo si një dhe e pandarë. Për të takimi ishte një hap i parë i rëndësishëm institucional për vëmendje ndaj fushës së letrave. Siç u shpreh ai *“Letërsia shqipe është ndoshta paradigma e vetme që ka mbajtur gjallë kombin edhe identitetin shqiptar. Është programi kulturor-politik dhe identitar i shqiptarëve. Historia e ideve kulturore shqiptare është organikisht e lidhur me letërsinë. Prandaj kërkohet prej të gjithë përgjegjësve të shteteve shqiptare edhe pjesëve të tjera, që të ndërjegjësohen dhe të marrin vendimet e dubura, sepse duke ndihmuar këtë, i bëjnë nder kombit edhe kulturës.”*

Në panelin e katërt, me autorët Anilda Ibrahim (Itali), Arben Dedja (Itali), Entela Tabaku (Suedi) e Shqiptar Oseku (Suedi) në moderimin e Prof. Diana Kastrati u diskutua për temën: **“Letërsi identitare apo Identitete gjuhësore e kombëtare likuide?”** Autorë që shkruajnë vetëm në gjuhën shqipe si Entela Tabaku e Shqiptar Oseku, autorë që shkruajnë në dy gjuhë apo vetëm në gjuhë të huaj si Anilda Ibrahim e Arben Dedja shtjelluan temën e identitetit në letërsi, duke u fokusuar tek gjuha dhe në atë çka e bën veprën e tyre të ketë ose jo përkatësi kombëtare.

Në panelin e pestë, me autorët Bessa Myftiu (Zvicër), Ismete Selmanaj Leba (Itali), Flutura Açka (Holandë) e Virion Graçi, në moderimin e Prof. As. Lili Sula, me temë:

“Udhët e kthimit: lashtësia e një miti modern” theksi u vu në karakterin atdhetar të krijimtarisë artistike. Duke u nisur nga Atdheu si një nga konstantet më të rëndësishme tematike e ideore të historisë së letërsisë sonë, nga këndvështrimi në letra i atdheut larg e afër, u bashkëndanë përvoja artistike e personale të autorëve të ftuar, me qasjen për të përfutur pamjen e atdheut te sotëm në letrat shqipe, përmes veprave të autorëve bashkëkohorë.

Nëse takimi nisi me trajtimin e një hapësire të përbashkët bashkëndarjeje të krijimtarisë, ideve dhe problemeve siç është revista, edhe në mbyllje u zgjodh pikërisht një temë që ka të bëjë me rrugët e mënyrat që duhen gjetur për një promovim më të mirë të letërsisë shqipe, përmes temës **“Përkthimi dhe promovimi i letërsisë shqipe jashtë vendit”** me autorët, përkthyesit e botuesit Albana Shala (Holandë), Eleana Zhako (Belgjikë), Iskra Thoma (Itali) e Livio Muçi (“Besa editrice” – Itali) në moderimin e gazetarit Ben Andoni. Në këtë panel u theksuan disa nga rrugët për mbështetjen e përkthimit të letërsisë shqipe, si: projekti i përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj i hapur në vitin 2016 nga Ministria e Kulturës, mbështetja e përkthimit të letërsisë shqipe nga rrjeti TRADUKI, apo projektet e përkthimit të Europës Krijuese, pjesë e të cilave Shqipëria u bë në vitin 2014. Megjithatë, të gjitha këto janë shumë pak përballë nevojës që ka letërsia jonë, e shkruar në një gjuhë të rrallë, për t’u përballur, njohur dhe komunikuar me letërsitë e vendeve të tjera.

Si shembull të mirë për një komunikim të tillë, Qendra e Botimeve për Diasporën ftoi drejtuesin e festivalit “Passaggi” në Itali, z. Giovanni Belfiori, me qëllim njohjen e autorëve shqiptarë, përzgjedhjen dhe ftesën e tyre për pjesëmarrje në këtë festival, si dhe vendosi bashkëpunim me një nga gazetatat më të mirënjohura të Italisë “Corriere della sera” për të prezantuar faqen kulturore “Letture” në të cilën gazetarja e dërguar Jessica Chia do të paraqesë në të ardhmen edhe pjesë nga autorët shqiptarë.

Një hap drejt krijimit të urave të komunikimit dhe bashkëpunimit mes krijuesve ishte dhe botimi i “Letra nga Diaspora” nga Qendra e Botimit për Diasporën ku përmbledhet krijimtaria e përzgjedhur e autorëve të ftuar, revistë e cila në të ardhmen do të konceptohet si një forum komunikimi mes mbarë shkrimtarëve të letërsisë shqipe.

Nëse nisemi nga pyetja e shtrëna në fillim: Përse mund të mblidhen në një kuvend shkrimtarët? Përgjigja mund të ishte për gjithçka u paraqit më sipër: për të njohur më mirë njëri-tjetrin dhe veprën e secilit, për të kuptuar dhe debatuar rreth çështjeve thellësisht letrare, por edhe rreth problematikave të ndryshme që shqetësojnë autorin shqiptar, për gjetjen e rrugëve për një promovim dhe njohje më të mirë të letërsisë shqipe, për një komunikim më të natyrshëm mes letrave shqipe, për të shkërmoqur “atë bunker të vendosur mes diasporës së vjetër dhe asaj të re”, siç u shpreh në letrën e tij përshëndetëse shkrimtari Gazmend Kapllani. Takimi ishte një mundësi, sipas tij, që “diaspora që po ringjallet të gjejë sërish identitetin e saj të lëkundur duke ndërtuar urat e komunikimit me Atdheun, për të zëvendësuar bunkerin me biblioteka dhe librari.”

Por përgjigja për domethënien e këtij takimi mund të përmbledhej dhe një fjalë të thjeshtë simbolike, siç i përgjigjen hebrenjtë ikanakë pyetjes në romanin e Novalis: “Për ku jeni nisur?”, “Gjithmonë drejt shtëpisë”.

Ky takim ishte edhe një ftesë simbolike për t’u kthyer në shtëpi.



IMAZHE TË SHQIPTARËVE PËRMES AUTORËVE TË SHQUAR TË LETËRSISË BOTËRORE

(CHATEAUBRIAND • BYRON • WINTHER • SHELLEY • HUGO • DUMAS
TENNYSON • PIRANDELO • AMICIS ...)

nga Prof. Dr. Ferid Hudhri

Ilustrimet përbëjnë një numër të madh të krijimeve me temë shqiptare. Për vetë llojin e tyre artistik ato realizohen në një kohë më të shkurtër dhe zakonisht për të njëjtin subjekt, album, libër, antologji, përmbledhje apo cikël tematik të ilustruar, përftohen dhjetëra imazhe prej këtij zhanri. Pjesa më e madhe e ilustrimeve janë bërë me porosinë e botuesve, shkrimtarëve, udhëtarëve, apo koleksionistëve e autorëve të tjerë të ndryshëm, gjatë parapërgatitjes së librave të tyre kushtuar botës shqiptare.


Nga më të hershmet janë ilustrimet e botimeve për Skënderbeun. Krahas cikleve më të plota nga gravuristët e njohur gjermanë, Jost Aman (1539-1591) e Jorg Breu (1510-1547), figura e heroit të shqiptarëve ka zënë vend edhe në ilustrimet e mëvonshme, në romane e krijime të tjera letrare, të botuara në shumë vende të botës.

Një numër i madh imazhesh shqiptare janë shfaqur nga ilustrimet e përrallave. Në këto punime, përmes imagjinatës së piktorëve, mbështetur edhe në realitetet e trilluara të përrallave falë fantazisë, janë krijuar pamje nga më të larmishmet dhe më interesantet, që nuk i gjejmë në pikturat, litografite apo veprat e tjera të mëparshme, të realizuara për ekspozitat e kohës. Një pjesë e këtyre ilustrimeve është bërë nga piktorë që nuk kanë qenë asnjëherë në Shqipëri dhe, në këtë rast, paraqesin shumë interes pikërisht përfytyrimet e tyre figurative lidhur me imazhin mbi shqiptarët, të cilat

janë krijuar sipas subjekteve të tregimeve, përrallave apo krijimeve të tjera letrare, si p.sh. gravurat e piktorëve Ilse Bischoff (1903-1990), Miska e Maud Petersham (1888-1960), Georgy Alexandrovich Klodt (1923-1994) etj.

Zakonisht ilustrimet për shqiptarët gjenden nëpër gazeta, revista, libra e albume kushtuar Shqipërisë apo vendeve të Ballkanit. Por nga kërkimet për këtë botim janë zbuluar se imazhe të botës shqiptare gjenden edhe në libra e albume të tjera. Pesë prej këtyre botimeve, ku është e pranishme Shqipëria, u janë kushtuar pesë prej figurave më të shquara botërore: François René de Chateaubriand (1768-1848), njëri prej krerëve të romantizmit, ndër emrat më të shquar të letërsisë franceze; George Byron (1788-1824), poeti i famshëm i romantizmit anglez, i quajtur *Prometheu i shekullit XIX*; Alfred Tennyson (1809-1892), laureati i poezisë në Britaninë e Madhe gjatë mbretërimit të Mbretëreshës Victoria; Alexandre Dumas (1802-1870), një prej autorëve më të lexuar nga letërsia franceze; Mary Shelley (1797-1851), njëres prej shkrimtareve më të shquara të shekullit XIX, autore e librit "Frankenshtajni ose Prometeu modern" (*Frankenstein or The Modern Prometheus*).

Në librin "Album i Chateaubriand-it" (*Album de Chateaubriand*, Paris, 1862, f. 98-99) është botuar gravura që paraqet një vajzë shqiptare me shkrimtarin e shquar francez. Gravura ilustron shkrimin me




Bariu i vogël shqiptar, ilustrim për librin kushtuar Bajronit, Nju-Jork, 1849

titull "Chateaubriand i sëmurë te një shqiptar" (*Chateaubriand malade chez un albanais*). Autori përshkruan se si u ndodh aty me vajzën shqiptare. Midis të tjerave Chateaubriand tregon se një ditë gushti të vitit 1806 ishte me ethe dhe detyrohet ta kalojë mbrëmjen në familjen e një shqiptari që banonte në periferi të Athinës. Të nesërmen, kur zgjohet, sheh vajzën e mikpritësit shqiptar, *një vajzë shumë të bukur*, shtatëmbëdhjetë apo tetëmbëdhjetëvjeçare, që i shërbente për të kaluar ethet. Pikërisht këtë çast e kanë përjetësuar në art piktori Steal (që ka bërë vizatimin) dhe Monnin (që ka gdhendur gravurën). Është krijim i bukur që shpreh respektin e shqiptares ndaj shkrimtarit të shquar dhe vlerësimin e këtij gjesti nga vetë shkrimtari si dhe të dy artistët francezë.

Në vitin 1849 është botuar një libër i ilustruar me gravura të cilësisë së lartë për Bajronin (*The Byron Gallery of highly finished engravings, illustrating Lord Byron's works*, New York, 1849). Aty janë përmbledhur pjesë të zgjedhura nga krijimtaria e poetit, të shoqëruara me gravura. Midis faqeve 42-44 me titullin "Shqipëria" (*The Albania*), janë përfshirë vargje për shqiptarët nga poema e njohur *Çajld Harold*, shkruhet për kostumin shqiptar, për takimin e Bajronit dhe Hobhouse-it me Ali pashën në Tepelenë; paraqitet edhe një fragment nga letra e poetit dërguar nënës së tij, kur i shkruan edhe për veshjet shqiptare. Të gjitha këto ilustrohen nga gravura që ka të njëjtin titull, *The Albania*. Në atë gravurë paraqitet një bari i vogël me veshje tradicionale pranë bagëtive në një peizazh të bukur malor. Krahas tablosë *Bajroni me veshje shqiptare* (nga Thomas Phillips më 1813), e shumëfishuar më pas edhe nga disa autorë të tjerë në pikturë e teknika të ndryshme, gravura e mësipërme është një tjetër vepër e bukur arti kushtuar shqiptarëve frymëzuar nga poeti i shquar anglez.

Midis vlerave të çmuara që ruhen në Koleksionin Mbretëror në Londër (Royal Collection Trust, RCIN 1005099) gjendet edhe një kopje e librit me poema të Alfred Tennyson-it, ilustruar nga piktori Edward Lear (*Poems of Alfred, Lord Tennyson, illustrated by Edward Lear*, London, New York, 1889). Është botim special, i lidhur me lëkurë keci ngjyrë të kaltër, me dedikimin e Lordit Tennyson për Mbretëreshën Victoria. Ky libër doli nga shtypi dhe u dhurua mbretëreshës një vit pasi Edward Lear-i kishte vdekur (1888). Me atë përmbledhje të përbashkët përjetësohet edhe miqësia midis poetit më të njohur të Britanisë me piktorin që ka bërë pikturat më të bukura për Shqipërinë. Tennyson-i u njoh me vendin e shqipeve përmes pikturave të Lear-it. Nga pikturat për Malet



Haideja, ilustrim i një piktori italian për librin *Konti i Montekristos* të shkrimtarit Alexander Dumas

Akrokeraune, malin e Tomorit dhe veprat e tjera që realizoi gjatë vitit 1848, poeti i njohur anglez shkroi një vjershë në gjashtë strofa. Strofa e tretë, që është përdorur edhe si diçiturë për tablonë *Mali i Tomorit*, është paraqitur për lexuesin shqiptar nga autori i kësaj enciklopedie që në vitin 1987: *Tomor e Athos, fron magjie/ vjen hija e largët gjer tek ne/ peneli yt këtu i bie/ e ndiej si t'isha vetë atje* (shqipëruar nga Xhevahir Spahiu, gazeta *Drita*, Tiranë, 6 dhjetor 1987, f. 15).

Ndërsa një nga imazhet më të bukura kushtuar një vajze shqiptare është pikturuar për të ilustruar tregimin e shkrimtares Mery Shelley. Vizatimi është bërë nga piktori Henry Corbould, ndërsa gravurimi nga Charles Theodosius Heath (1785-1848). Me librin “Syri i keq” (*The Evil Eye*, London, 1830), ku personazhe kryesore janë kapedani Dhimitër (i lindur në një fshat malor midis Tepelenës, Përmetit dhe Gjirokastrës) dhe vajza e tij Zela, indirekt janë të pranishëm edhe dy poetët e shquar britanikë. Në kohën kur shkruante, Mery jetonte me poetin Persy Bysshe Shelley, ndërsa kur e botoi vendosi në krye të tregimit tri vargje kushtuar shqiptarëve nga *Çajld Haroldi* i Bajronit.

Për romanin *Konti i Montekristos* të Alexandre Dumas janë bërë ilustrime të ndryshme me imazhin e vajzës së imagjinuar të Ali pashë Tepelenës, Haidesë, personazhe e romanit. Nga piktori anglez James McConnell u realizuan disa akuarele, po ashtu edhe nga autorë francezë e italianë. Përmes këtyre punimeve jepet përfytyrimi i artistëve për vajzat shqiptare.

Krahas ilustrimeve të mësipërme, të botuar në librat e pesë prej figurave më të shquara të letërsisë botërore, imazhe të botës shqiptare janë realizuar edhe nga dora e dy autorëve autorëve po aq të rëndësishëm botërorë: Victor Hugo (1802-1885) dhe Luigi Pirandello (1876-1936). Kur shkruante poemat *Dervishi* dhe *Kështjella*, aty ku përmendet Ali pashë Tepelena me kalanë e tij, shkrimtari i shquar francez e ka krijuar imazhin e kështjellës edhe përmes një akuareli, ndërsa shkrimtari italian Luigi Pirandello, fitues i çmimit Nobel (1934), në një letër dërguar poetit arbëresh Giuseppe Schiro (1865-1927) i shkruante se *kishte pikturuar figurën e një burri nga Shqipëria*.

Midis pikturave më të bukura të artit danez i është vlerësuar edhe tabloja kushtuar një vajze shqiptare në Italinë e vitit 1831. Sipas përshkrimeve në dy libra të historisë së letërsisë dhe artit danez shqiptarka ka qenë e dashura e poetit të njohur Christian Winther (1796-1876). Tekstualisht në ata libra shkruhet: *Christian Winther kishte rënë në dashuri me gruan e mrekullueshme shqiptare dhe i kërkoi Kuchler-it ta pikturonte...* (*Dansk Litteratur Historie*, Kopenhagen, 1976, f. 90). Disa



Vajza shqiptare dhe Chateaubriand, ilustrim për “Albumin e Chateaubriand-it”, Paris, 1862

vjet më parë piktori Kuchler, me porosi të poetit Christian Winther, i pikturoi të dashurën e tij, një zonjushë të mrekullueshme shqiptare. Në këtë pikturë, ai arriti të realizojë bukurinë dhe hijeshinë femërore që nuk e përsëriti më në veprat e mëvonshme... (*Dansk kunst. Tusind ars kunsthistorie*, Kopenhagen, 2004, f. 237). Kjo tablo ruhet në Ny Carlsberg Glyptotek të Kopenhagës.

*

Ndonëse më rrallë, ilustrime grafike vazhdojnë edhe në ditët e sotme, në teknika të ndryshme, siç ka ngjarë me ato të piktores franceze Maryanick Ricart dhe fotografit Yves Rousselet, të cilat u përdorën për ilustrimin e përmbledhjes me poezi, përgatitur dhe përkthyer në frëngjisht nga Ardian Marashi (Paris, 2007), ose me akuarelin e piktores Tina Negus për kopertinën e librit *Albanian Poems of Desiderance*, si dhe botime të tjera letrare. Përmes ilustrimeve u angazhuan me temën shqiptare artistë të njohur, si Gustav Doré (1832-1883), Caton Woodville (1850-1927), Daniel Vierge (1851-1904), Jacque-Raymond Brascassat (1804-1867) dhe autorë të tjerë që paraqiten në faqet e kësaj Enciklopedie.



Vajza shqiptare Zela, ilustrim për librin e shkrimtares Mery Shelley, Londër, 1830

(nga Enciklopedia “Shqiptarët në Artin Botëror”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë)



Vajza shqiptare Zela, ilustrim për librin e shkrimtares Mery Shelley, Londër, 1830

SHIU I VERËS

shiu i verës
dush i ngrohtë
i vrullshëm
të ngjitet mbas trupit
e të rrëmben me vete
dufshëm

shiu i verës të deh
si vera gjakun ta vlon
kur vjen nga dielli
i nxehur ethesh
gjithë duhma
krijon lumenj gjethesh

shiu i verës
vjen i dehshëm
ky kalërues resh
i pa mehshëm
kur shfaqet papritmas
në një skenë teatrore apokalipsi
me armë letale
duke bërë sa hap e mbyll sytë
dete e oqeane me petale

shiu i verës
dush i ngrohtë
i vrullshëm
rrëmben me vete
gjithçka
që do
dufshëm

SHIU LAG SHIUN

shiu bjen
mbi shi

shiu lag
shiun

shiu i tashëm
bjen
mbi gjurmët
e shiut
të pakmëparshëm

shiu i pakmëparshëm
fshihet
pas gjumëve
të shiut të tashëm

shiu i tashëm
ia fshin
gjurmët
shiut
të pakmëparshëm

shiu i pakmëparshëm
bëhet
shi i mëparshëm
i shkuar
i tejshkuar
i paskajshëm

shiu i tashëm
bëhet fill shi
i pakmëparshëm
i mëparshëm
prej shiut



SHËN SHIU

cikël poetik nga

Elida
Buçpapaj



të ardhëm
që bjen mbi
shiun e tashëm
dhe lag
shiun
e pakmëparshëm

shiu i ardhëm,
i tashëm,
i pakmëparshëm,
i mëparshëm
i shkuar
i tejshkuar
i paskajshëm

është shi
që bjen mbi shi

është shi
që lag
shiun

SYTË E SHIUT

sytë e shiut
e shohin të gjithë
botën mbarë
pa kufij
nga njëra hemisferë
tek tjetra

sytë e shiut
futen thellë në çdo skutë
aty ku nuk futen dot
sytë e njeriut
në trupin e pyllit
në trupin e zjarrit
në trupin e oqeanit
në trupin e vullkanit

sytë e shiut
janë infiniti
që nuk lënë hollësi
pa parë
për të zbuluar
të panjohurën
në infinit

sytë e shiut
e përpjnë
universin

kur mbizotëron
ngjyra gri e hirit

sytë e shiut
kuriozë e
shigjetues
fiksohen
pas dritareve
atje ku bota fshihet
prej syve të shiut

sytë e shiut
pëlqejnë përgjumjen
pas dritareve
duke kundruar
etshëm
botën njerëzore

atëher' sytë e shiut
bëhen transparentë
dhe e ëndërrojnë
sikur të mbeteshin të fiksuar
në dritare përgjithmonë

sytë e shiut
janë ngjyra ngjyra

kur sytë e shiut
qendrojnë
në sqepin portokall
të mëllenjave
është pranverë

kur sytë e shiut
kryqëzohen
me sytë e diellit
shfaqet ylberi

kur njerzve u rigon
shi prej syve
e kur nga sytë e shiut
rrjedhin lotë
në këtë çast
njeriu e hedh tutje ombrellën
e sytë e shiut
depërtojnë
përtej rrobave
përtej lakuriqësisë
ateher është
një moment
i rrallë kur
njeriu dhe shiu
shihen
sy për sy
me njëri-tjetrin
sikur të ishin të dy njerëz
apo të dy pika shiu



ZANI I SHIUT

zani i shiut asht
me plot variacione
për violinë

e keni nigju zanin e shiut
kur fishkëllon si gjarpni
në gëmushë
tuj lujt kukamçefiti me rrfetë ?

po kur
trokon si treni që të sjell
në qytetin e lindjes
zbrazun nga banorët
e i banum veç
prej shiut?

zani shiut
asht i zemrum
kur i qëllon
dritaret me guralecë

pastaj paqtohet
bahet i përgjumshëm
pastaj zbutet
bahet si qingj
s'i nihet zani
atëher' shiu asht
kopshtari që e mbush vetminë
tuj ledhatu fytyrat e luleve
e gishtat e barit

kur shiut si ndihet zani
asht herë herë i gzumë

kur shiut s'i ndihet zani
dhe me orë kilometrike
rri i veshun me veladonin e
heshtjes
i varun gërmuq
kremastarëve të reve
atëher dijeni
se asht tuj kajt
pa za
mbi varret e atyne
që i kish pas njoftë
dikur

kur shiu qan
me za
pandalshëm
me za shiu
me e ndigju të gjithë
atëher' asht një çast
kur shiut i vjen me folë
fjalë të njeriut
në të gjitha
gjuhët e botës
për me e tregu
vuajtjen e njerëzve
në ndarjen
e fundme



BIBLA

tregim nga

Uran Butka



Marash Nik Pepa kishte nevojë të fliste me dikë. Po nga njëra anë kishte murin e akullt, nga tjetra Kostrecin, më i heshtur se muri. Kthehej e vërtitej mbi shtratin e ngushtë dhe s'gjente prehje.

- Të rrodhën sytë, bre burrrë! - i tha Kostrecit, që vazhdonte të lexonte pa u trazuar.

Drita e mekur hynte me mundim nga kamaret e qelisë. Një afsh i rëndë, gjithë lagështirë e kundërmim myku, të zinte frymën. Marashi u ngrit ndenj. Përveshi këmbëzën e majtë të pantallonave dhe këqyri me kujdes cungun e këmbës së prerë, që kishte nisur përsëri t'i gangrenizohej. Shtypi me gisht pjesën e murrëtyer, ku mbeti një gropë e frikshme. Ëhë! tha ai me vete dhe mblodhi buzët, aq sa ato iu futën brenda gojës. Nxori nga xhepi i brendshëm i xhupit të pambuktë qesen me duhan dhe ia çeli grykën. Kundërmimi i duhanit ia shpoi hundën dhe atij iu duk sikur ai u përhap gjithandej si një mjegull e mermë. Rrasi majën e hundës në krifën e ngatërruar të fijeve të kuqërremta dhe qëndroi në përthithje për një kohë të gjatë.

Tjetri, përbri, luajti vendit, por nuk e lëshoi librin. Marashi ishte mësuar me përqëndrimin dhe heshtjen e Kostrecit. Një ditë më parë ky kishte dalë nga kaushi. S'kishte muaj që të mos dënohej atje për mosbindje. Marashi ia kishte larë plagët dhe, ku i rridhte ende gjak, i vinte duhan. "Si të paskan bërë, mor vëlla!" Po Kostreci nuk ankohej, madje bënte humor: "Mos e shko dëm duhanin, or bacë!"

Marashi nxori hundën nga tharmi i helmët. Mendjen e kishte te gropëza e mavijosur. Vdekja e kishte zënë për këmbësh dhe e kafshonte. Dy herë ia kishin prerë njëren, në fillim nën gju dhe mandej mbi gju. S'paskam derman! mërmëriti hidhur dhe nxori pak duhan nga qesja, por harroi që s'kishte letër. Kur ke njëren, s'ke tjetren, u qa. Zakonisht e dridhte me gazetë, ose me atë letrën ngjyrë kafe, që mbështilleshin makaronat. E keqe, e keqe ajo, po ku ta gjes, tha gati me zë të lartë. Duhani i vinte nga Thethi. Vetëm duhan të grirë kërkonte nga shtëpia, asgjë tjetër. Duhani i Thethit kishte ngjyrën e mjalit dhe aromën e bleshkëve. Por ia ndërronin gardianët me duhan që kundërmonte erë të qelbur. Gjithsesi, e pinte. Në takimin e fundit me nipin, kishte siguruar një qese me duhan bleshke. E kishte ndarë në ngastra dhe e llogariste për një kohë të gjatë, anipse asnjëherë nuk i dilnin hesapet. Këtë herë i mungonte letra krejt. Ajo ishte më e kërkuara në burg. Sikur të kishte, qoftë edhe vetëm një fije letër, do ta dridhte një cigare dhe do ta pinte, kur të shkonte në banjë ose kur të dilte për ajrim.

Iu kujtua papritur një ngjarje, që e bënte të vuante. Përpiquej ta harronte, po s'e kishte në dorë. Sa herë kam duf për duhan, më del parasysh, mendoi me dhimbje dhe solli ndër mend çastin, kur kishte dalë për ajrim, kur çapitej pas të tjerëve mbi njëren këmbë dhe mbi bastunin nga ana tjetër. Mendjen e kishte gjetkë. Të nesërmen do t'i prisnin këmbën për të dytën herë. Dhe i dukej se vërtitej në qerthoren e ajrimit, si në një vorbull. Njëri prej rojave thithte një cigare dhe tymin ua hidhte të burgosurve në fytyrë. Marashi ia nguli sytë atij. Çdo

mendim, çdo lëvizje e përqëndroi te cigarja e rojës, që digjej ngadalë e qetësisht, si për torturë të Marashit. Kur kalonte pranë tij, e ngadalësonte hapin. Ndoshta mund ta hedhë tani, mendonte në ethe. U desh edhe një rrotullim, ndërkohë roja e flaku përtokë bishtin e mbetur. Sikur ta kishte llogaritur, u ndodh pranë dhe u përkuq që ta merrte. Mirëpo roja, që e kishte ndjekur me sy, shtriu këmbën me forcë dhe këpuca e tij ushtarake shkeli mbi gishtat e Marashit. Ky e tërhoqi menjëherë dorën e gjakosur, ndërsa tjetri shqyente me shollën e këpucës bishtin e cigares. Sikur po më shtypte mua, foli nën zë Marashi.

- Merr ndonjë libër! - i kishte thënë Kostreci, kur ishin kthyer në qeli. - Mbase e humbet mendjen. Kërko Dom Nikollës Biblën.

Marashi e takoi të nesërmen Dom Nikollë Mazrekun. Ishte një burrë i pashëm, rreth të gjashtëdhjetave. Të burgosurit e respektonin për dijen, zemrën e mirë dhe karakterin e fortë.

Dom Nikolla ia dha me kënaqësi Biblën dhe e porositi ta mbante mirë. Ishte një libër i trashë, me kapakë të lëkurtë dhe gërma ari përsipër. Marashi u mbështet pas murit dhe nisi ta shfletonte. Fletët ishin të holla, të tejdukshme dhe fëshfëritëse. Qenkan të mira për të dredhur duhan! - tha me vete. E shfletoi deri në fund, plot një mijë e dyqind faqe, shkruar me gërma të vogla, të zeza. Nisi të lexonte fillimin, por nuk përqëndrohej dot. "Ajo fleta e mbrame, kot është! - mendoi. E pashkruar. Po ta heqësh, nuk prish punë. Me atë dridhen, të paktën, tridhjetë cigare..."

I doli parasysh fytyra e merakosur e Dom Nikollës dhe e largoi atë mendim. "Të njeriu është edhe Zoti, edhe Djalli. Zoti ma dërgoi këtë libër për ta lexuar, djalli më shtyn për ta shqepur!". E mbylli dhe e vuri nën jastëk.

U kthye nga gjitoni, që e kishte lënë librin mënjanë dhe ishte kredhur në të thella. "Me siguri po thurr poezi. I shkruan në kujtesë, ndaj shpesh duket sikur flet me vete." Një ditë gardianët i kishin mbledhur gjithë librat. Kostreci hyri në grevë urie. Grevë për librat, s'ishte dëgjuar ndonjëherë! As hante, as pinte. Operativi, një djalë i ri, në prani të Marashit e qortonte:

- Kështu do të mbarosh, para se të të vijë vdekja!
- Nuk vdes, se kam Zotin mbrojtës.
- Pse, ka Zot?
- Po.

- Nga e di?
- Se ai më bëri njeri të librave, nuk më bëri kriminel...
- Po të kishte, nuk do të ishte këtu.
- Zoti nuk t'i jep të gjitha. Kjo është një provë.

Dha e mori operativi, po s'e bindi dot Kostrecin të hiqte dorë. Ishte menjëherë pas revoltës së Spaçit. Nuk donin të kishte përsëri ngjarje të atilla nëpër burgjet. Ua kthyen librat, ato të lejuarat...

Marashi e hoqi mendjen nga Kostreci dhe e zbuloi përsëri cungun. Ngjeshi gishtin e madh mbi të dhe gropa që u formua, qe më e madhe. Atij iu duk si një hon. Ka marrë gjithë kockën, mendoi hidhur. Nxori Biblën nga nënkresa dhe u kthye nga muri. E tërhoqi ngadalë fletën e fundit, derisa e shpëputi nga libri. Gërvima iu dëgjua si një klithmë fëmije dhe ai u drodh. E shtyu librin ku ishte më parë. Ndjeu se zemra i rrihte fort. E ndau në lehëza fletën e bardhë. Iu duk sikur kuisjen e letrës e dëgjuan të gjithë. Qëndroi pak çaste dhe mbajti vesh. Nga larg dëgjoheshin zëra dhe hapa. U kthjellua: ishte koha e ajrimit. Mori një copëz letre, e vendosi si lug mbi dy gishtat, shtroi mbi të duhan dhe nisi ta dridhte me shpejtësi. Po duart i dridheshin. Me majën e gjuhës lagu anën e letrës dhe e ngjiti cigaren. Dera e hekurt brambulliti dhe u hap. Marashi u ngrit duke u mbajtur në mur, kapi bastunin dhe doli pas Kostrecit në oborrin gjysmë të errët. Këmbëza boshe e pantalloneve i varej e i tundej si një bisht. Kishte harruar ta mblidhte. Pasi bëri disa hapa, qëndroi, nxori cigaren e dredhur nga xhepi i brendshëm i xhupit tegela - tegela, të cilit i kishte dalë pambuku i zi vende - vende dhe e ndau mëdysh. Pastaj shpejtoi, e arriti Kostrecin dhe i zgjati gjysmën. E ndezën tek një tjetër dhe e thithën në heshtje, duke u çapitur ngadalë pas të tjerëve.

- S'kam pirë në jetën time cigare më të mirë! - tha Kostreci. - Ndoshta, kështu më duket.

Kur u kthyen në qeli, secili u ul në cakun e vet.

- E fshtollam një fletë të Biblës! - i tha ngadalë Marashi.

- Ç'thual?

- Me fletën e mbrame. S'kishte gjë të shkruar, veç emrin e shtypshkronjës dhe vitin.

- Po flet përçart! - ia priti tjetri me tërsëllim..

- Nuk durova dot, s'pata forcë ta ndalja dorën...

- Paske bërë mëkat të madh! Ta dija, s'do ta kisha pirë kurrë.

Të dy nuk i zuri gjumi atë natë.

Llamba elektrike ndriçonte zbehtë që nga lart. Ishte e ndaluar ta fikje dritën natën. Marashi këqyrte fytyrën e Kostrecit dhe dallonte atje një vuajtje të madhe. Vuan për mua, mendoi. Kokën e shogët ia përshkonte një brazdë e lehtë, shenja e një plumbi. Kishte dashur të arratisë apo të vetëvritej, nuk dihej mirë. Ai vetë nuk thoshte gjë. As i shkonte asaj ane. Rojat e kishin paralajmëruar, por kostreci ecte i qetë, ngjiti murin dhe u var tek telat me gjemba. Krisi automatiku dhe plumbat i përshkuan mushamanë e zezë, që ngjante me një tabelë të lëvizshme qitjeje. Një plumb i fshiku tërë rrafshin e kokës dhe e mbuloi gjaku. E kishte kërkuar vdekjen Kostreci, apo donte të shpëtonte nga vdekja? - pyeste veten Marashi.

Ditët rrokulliseshin në humbëtitë. Marashi e ndjente gjithnjë e më afër vdekjen, që ngjitej lart nëpër llagëmin e kockës. Trishtimin përpiquej ta shuante me duhan. S'donte të bezdiste të tjerët. Tanimë e kishte zgjidhur hallin e letrës. Hapin e parë e pati të mundimshëm, të tjerët i bënte vetvetiu. Nuk e brente më ndërgjegja, u regj në atë punë. I këpuste fletët një e nga një, si dimri gjethet e një peme. Bibla po hollohej, po tretej ngadalë së brendshmi. Dikur asaj i mbetën vetëm kapakët e trashë, zhguni. Sikur ta kishte përpirë tenja. Vetëm atëherë ia tregoi të fshehtë mikut të tij, ndonëse ai me siguri e dinte.

- Si t'i them Dom Nikollës?

- Të vërtetën thuaji. Kjo ta lehtëson shpirtin.

Marashi shkoi drejt e tek ai.

- Kam bërë një mëkat të madh, Dom Nikollë.

- Mëkatet janë njerëzore, biri im! Ato falen, kur pendohesh.

- E kam bërë me dashje...

- Sido që të jetë!

- Kam pirë Biblën.

- Si e ke pirë!?

- Me duhan.

Dom Nikolla s'po e merrte vesh. Mendoi se s'ish në vete.

- Qetësohu, biri im, qetësohu!

Marashi nxori nga brendësia e xhupit të kaftë zhguallin e Biblës.

Dom Nikolla u tmerrua dhe nisi të bërbëliste. Pastaj e mblodhi.

- Po ta kishe lexuar, kurrë s'do ta kishe bërë këtë mëkat! - i tha.

- E di.

- Bibla është libri, me anë të të cilit Zoti flet dhe zbulon vetveten.

- Nuk do të më falësh?

Dom Nikolla nguroi.

- Në thellësi të shpirtit nuk je penduar, nuk je i qetë.

Diçka tjetër të mundon, biri im!

- Është e vërtetë, atë! - iu përgjigj Marashi. - E kuptova: vetëm pendesa nuk mjafton. Duhet...

Iu këput fjala. Ktheu shpinën dhe iku ngadalë si një hije në pakthim... S'donte ta lëshonte veten. Kalbësira i kishte marrë gjithë kurmin. Po shpirti? A do t'i kalbej edhe ai?

Pas disa ditësh, ndjeu një dhimbje të madhe dhe i humbi ndjenjat. Në spital ia prenë përsëri këmbën, gjer në rrëzë të kofshës. Kur e sollën në qeli, nuk e njohën. Kishte ndërruar. Kostreci i qëndronte mbi kokë dhe i pastronte plagën e mahisur. Marashi nuk ndiente gjë. U përmend vetëm kur Dom Nikolla i mori dorën në mes të duarve të veta dhe i foli në gjuhën e Zotit. Hapi paksa sytë, lëvizi me mundim buzët e thara dhe tha me një fije zëri:

- Më ndje, Dom Nikollë!


Sytë i ikën dhe koka iu var.

Dom Nikolla i bëri shërbesën e fundit.

(Marrë nga vëllimi me tregime dhe novela "Vuajtja e bukur", 2019)

HISTORI PA BIOGRAFI

Ese nga Rexhep Ferri



1.

Në këtë fushë të mejdanit, koha pa emër nuk di
çka duhet të bëjë.
Çdo fjalë vret.
Edhe heshtja e ka historinë e vet.
Veprimin e vet.
Interesimi është i madh.
Edhe pse nuk është koha për urime, me vite e
shekuj kemi jetuar me mitin e mashtrimit.
Herën tjetër do ta kuptojmë më mirë.
Tani ia kemi marrë dorën kësaj historie.
Qebesa edhe këtij qorfermani.
Kur flasim për të kaluarën, ndjesia e kohës së
tashme ndalet.
Parandjenja rrokulliset.
Më keq është të flasësh se të mos flasësh.
Këtu merr fund besimi në njeriun...

2.

Menaxherëve që merren me organizimin e
mbrëmjeve argëtuese a iu shkon mendja të pyesin
sa kushton një plumb qorr?
Kur i hapin sytë.
Nga të gjitha mbretëritë.
Në klubet e natës, deri në fund të natës s'kemi as
ndalesa e as kohë të mendojmë.
Jetë, e mjera jetë, mos ik!
Për ta harruar harresën!
Për ta shprehur habinë!?
Për një dell marrëzie kujt t'i drejtohem?
A ka njeri?
Pse dyshojmë.
Për njeriun që është bërë eksperiment, edhe diçka
tjetër do të mbetet në harresë.
Kohën e kemi të vjedhur...

3.

Këndeje detit dhe andej detit ka humbur e
ardhmja.
A është mirë? Jo!
A është histori e pashkruar? Po!
Më falni.
Mos u largoni.
Shpresat e kalojnë imagjinatën.
Si do të vdes unë nuk e di!
Im at' ka vdekur nga plaga e vet.
Me dritën e hënës e kemi varrosur.
Tani të kaluarën e shohim në fotografi.
Në rezervat e thesarit kombëtar nuk kanë mbetur
as gurët e varreve.
Për ta fshehur identitetin shumë lehtë bëhen
operacione plastike.

Në frymën artistike, kujt po i duhen t'i kositë
livadhet.

Bariu e baresha kaluan detin e përtej detit.
Për të shitur fytyrën e bardhë e për të blerë maskë
për mëngjes, mesditë e mbrëmje...


4.

Sa më shumë që duam të humbim, aq më shumë
e duam jetën.
Me dy, nga dy.
Me një nga një.
Është fjala e fundit.
Dhe bota e Madhe në Botën e Vogël.
Për botën, prapa botës, më lini të mendoj.
Kujt t'ia them të vërtetën?!
Vetmia ka shumë keqkuptime.
S'më shlyhet nga mendja.
Për të bërë më të mirën, me çdo gjë që na ka
mbetur, ku po shkojmë?
Ku po gabojmë?
Nuk po kuptojmë asgjë!...
Në qytetin e dëshpëruar, me shpresën e pashpresë.
Njeriu i vetmuar shëtiti si hije...

5.

Nuk ka pse të na vrasë ndërgjegjja.
Ajo ndjenjë dhe ajo fjalë nuk ekzistojnë më.
Jeta është bërë shumë komode.
Të gjitha kushtet janë për të jetuar mirë.
Por hajt e gjeje mesin e artë!
Te kufiri mes shqiptarëve para dite digjet një
flamur.
Pas dite digjet një flamur tjetër.
Për të shpëtuar nga plumbi qorr bëhet një pushim
i gjatë.
Kjo mendje e shkretë, ku po na çon?
A jemi të humbur a të papërgatitur, nuk kam
asgjë për të fshehur.
Nuk po gabojmë!...
Historisë nuk i bëhet vonë.
Për ne që ishim afër nuk dihet kur është ditë e
kur është natë.
Për të mbetur gjallë, dilemat vazhdojnë.
Histori pa biografi...

Janar, 2020



Ishte muaji shtator i vitit 1952, kur unë me gjyshen Itime (pasi nëna më la të vogël) vajtëm në Tiranë te xhaxhai. Aty më la gjyshja dhe vazhdova shkollën unike (sot shkolla 9-vjeçare). Më vonë vazhdova mësimet në shkollën pedagogjike dhe të lartën për histori-gjeografi.

Jetonim afër familjes së Sejfulla Malëshovës, që njihet me pseudonimin Lame Kodra, të cilin e përdorte në shkrimet letrare. Gjyshja e njihje, pasi kishin lidhje me nënën e tij, Pashakon, dhe me gjyshin tim, sepse fshatrat tona ishin afër njëri-tjetrit. Më vonë e pashë se njiheshin mirë sepse, kur vajtëm, e thirrën me emër sikundër thërrasim ata që njohim prej kohësh, si gjatë kohës së Revolucionit të Qershorit 1924 ose edhe në shoqërinë “Vatra”. Gjyshi im kishte qenë në Amerikë, SHBA, dhe kishte qenë edhe anëtar i shoqërisë “Vatra”. Kur erdhi nga Amerika, solli me vete 3 valixhe me libra në gjuhën shqipe dhe i shpërndau nëpër fshatra (mbase u zgjata si shumë). Por më çuditi pyetja e tij.

Para se të shkonte në fshat, gjyshja i tha djalit: “A të vete të takoj nënë Pashakon, se më thanë është sëmure? Takojmë edhe Sejfullain.”

Ai tha: “Shkoni.” Sejfullai është kritikuar, por nuk është i bllokuar.

Ai ishte kritikuar rëndë nga partia si oportunist dhe ishte shkarkuar nga posti i ministrit të Kulturës, por ishte akoma Drejtori i Përgjithshëm i Përkthimit (pasi si përkthyes, sidomos i gjuhës sllave, ishte mjeshtër i madh). Dinte rreth 12 gjuhë të huaja. Mund të quhet “poeti rebel”, sepse me pasion i këndoi lirisë dhe demokracisë në poezitë e tij.

Kështu një ditë të diel, së bashku me gjyshen, mbasi morëm leje nga xhaxhi, u nisëm për te familja e Sejfulla Malëshovës. Atëherë s’kishte shumë makina dhe ikëm më këmbë. Gjyshja përpara dhe unë mbrapa saj duke biseduar. Rruga ishte e shkurtër sepse, siç thashë më lart, fshatrat (shtëpitë) tona ishin afër.

Rrugës mendoja se si do të ishte ky personi i dëgjuar dhe mendimtar, poet dhe shkrimtar i madh. E kisha parë një herë kur isha më i vogël, kur ai erdhi në Malëshovë si deputet në zgjedhjet e 2 dhjetorit të vitit 1945. Populli e priti me nderime të mëdha, me brohoritje entuziaste dhe e merrnin në krahë.

Në Këlcyrë mbajti një fjalim para popullit, ku paraqiti edhe programin për zhvillimin e vendit dhe të krahinës. Më kujtohet se populli brohoriste dhe kërkonte që Sejfullai të dilte në ballkon. Kur doli, brohoritjet u shtuan më shumë dhe nuk pushonin, por ai me buzëqeshje dhe me durim priti derisa ra qetësi dhe nisi fjalimin si një ciceron.

Të gjitha këto i kujtoja gjatë gjithë rrugës dhe bisedat me gjyshen i ndërpreja kur arritëm afër shtëpisë së tij. Ishte një shtëpi përdhese e rrethuar me pemë dhe për t’u futur brenda, duhej të kaloje në një rrugë të ngushtë në të dyja anët e secilës ishin mbjellë me kujdes lule. Derën e gjetëm mbyllur. Gjyshja thirri emrin e nënës së tij, Pashakos. Ajo u përgjigj nga brenda me një zë të dobët. “Urdhëroni, ejani brenda!”

Gjyshja hapi derën, hymë brenda dhe pamë se Pashakojë ishte në shtrat, ishte e sëmure. Mezi u ngrit ndenjor dhe përqafoi gjyshen, edhe mua gjithashtu.

- Të lumtë këmba moj Meme (ishte emri i gjyshes), se na kishte marrë malli!

Ato filluan të bisedonin duke pyetur për shëndetin e njëra-tjetrës, por edhe për shoqet dhe njerëzit e të dyja fshatrave, të cilët i njihnin të dyja. Unë shikoja me kureshtje dhomat. Ishin dy të tilla, nga të cilat njëra ishte e mbyllur. Duke biseduar, gjyshja pyeti për Sejfullain.

Pashako u përgjigj duke thënë se Sejfullai ishte mirë me shëndet, por me punë të qeverisë...

- Besoj se e keni marrë vesh se si i ka. Ja, na kanë dhënë këtë shtëpi, në të cilën më parë kishte jetuar një oficer i lartë i ushtrisë italiane. Jemi ngushtë, se Sejfullait një dhomë i duhet vetëm për librat që ka. I them të martohet, por ai nuk do. Ja, për këtë kam merak. Dua ta shoh me familje para se të mbyll sytë e të shkoj përgjithmonë.

Më pas ajo i foli Sejfullait:

- Sejfulla, ngrihu nga gjumi se ka ardhur Meme e Lazes, t’i gostitsh!

Ndërkohë gjyshja ime tha:

- Mos e ngri nga gjumi, lëre të flejë.

NJË KUJTIM I PAHARRUAR ME SEJFULLA MALËSHOVËN nga Xhafer KORRO

- Ai do të ngrihet vetë tani, se i vajti ora dhe do të vejë në punë.

- Po pse edhe sot që është e diel vete në punë? - pyeti duke u çuditur gjyshja ime.

- Ai gjithmonë punon, nuk ka ditë pushimi për të. I kërkojnë të përkthejë librat.

Në këtë moment hapet dera. Hodha sytë me kërshe ri dhe pashë një burrë me kokën e rruar dhe shtatshkurtër. M’u kujtua motra e tij që kishim në fshat. Ngjanin si dy pika uji. Ai u përshëndet me gjyshen, e cila e puthi. Kur erdhi radha ime, më përqafoi. Shkëmbyen me gjyshen fjalët që thuheshin në raste të tilla. Më vonë na gostiti.

Më çuditi kur pyeti për gjyshin tim: “Si është Lazja?” Pastaj pyeti edhe për shumë të tjerë në fshat. Siç thashë më lart, u çudita edhe sepse ai, ndonëse kishte shumë vjet i larguar, mbante mend shumicën e banorëve të fshatit tonë. Kishte një kujtesë të fortë dhe të rrallë.

Më vonë pyeti gjyshen:

- Po këtë djalë, të kujt e ke?

- Këtë e kam të djalit të madh dhe e kemi prurë këtu të vazhdojë shkollën se mëson mirë. Ne në fshat, ashtu si e di edhe ti, merremi me blegtori e bujqësi.

- Shumë mirë keni bërë, sepse edhe blegtorja, djathi dhe gjiza që ju bëni, duan shkollë që të ecin përpara. Më ka thënë Pashakojë se ju keni edhe bletë, të cilat për t’u trajtuar e për t’u zhvilluar duan shkollë.

Pashakojë shtoi se me këto të gjitha merret djali i madh i Lazes, por edhe vetë Mam?????

Më vonë Sejfullai më rrahu shpatullat dhe më tha:

- Shumë mirë djalë! Të mësosh, se vendi ka nevojë për shkollë dhe shkollë do njerëz të mësuar, pasi pushtuesit na kanë lënë në errësirë. Një popull pa arsim sundohet më lehtë. Mëso, - përfundoi ai, - e t’i ngjasësh gjyshit tënd!

Më pas hyri në dhomën e tij, vuri kapelën republikane dhe doli nga dhoma. Nga dera e hapur e dhomës së tij, i çuditur, pashë librat që ndodheshin aty brenda. Libra kaq të mëdhenj nuk kisha parë më parë. Më vonë të tillë pashë edhe në shtëpinë e Petro Markos.

U largua duke na kërkuar falje se nuk mund të rrinte akoma me ne, sepse do të shkonte në punë. E ndoqa me sy kur i hipi biçikletës dhe derisa u largua e nuk dukej më.

Nga ajo ditë nuk e pashë më. Nga motra e tij që banonte në fshatin tonë mësuam për gjithë fatkeqësitë që i ndodhën më pas Sejfulla Malëshovës.

Ai u godit në vitin 1950. U përjashtua si deputet i zonës dhe më vonë e shkarkuan edhe nga detyra e Drejtorit të Përkthimeve. Më pas e internuan në Fier, ku punoi si magazinier, punë që ai e kryente me ndërgjegje të pastër. Kështu më thoshin bashkëfshatarët e mi që punonin si private në atë zonë.

Por ai nuk hapej, sepse ishte në survejim të rreptë. Kishte raste që kur vinte të hante bukë dhe i uleshin pranë, me zë të ulët iu thoshte: “Më falni, por është më mirë për ju të uleni më larg meje.” I thoshin fshatarët: “S’ka makarona, s’ka sheqer. Nuk gjejmë gjëkund.” E ai përgjigjej: “S’ka, s’ka asgjë me tek?”

Më vonë shkrimtari Petro Marko, kur e pyeta për Sejfulla Malëshovën, më tha: “E kam takuar për herë të parë në Itali.” Ai kërkoi politikën e dyerve të hapura. Në Berat u tha: “Ne jemi shtet i sapodalë nga lufta. Vij nga Moska dhe duhet që diferencimin politik ta mbajmë, por Shqipëria ka nevojë për peronën e ndryshkur të Perëndimit.” Për këto mendime të tij ai u quajt oportunist. “Unë i thashë, - vazhdoi Petro Markoja, - ki kujdes Sejfulla se këtu jemi në Shqipëri dhe në Ballkan dhe nuk duhet folur kaq hapur”.

Unë isha student i mirë në letërsi. Shkoja shpesh te shtëpia e tij, që ishte afër kinemasë “17 Nëntori”. Aty bisedonim gjatë me Petro dhe Safo Markon. (Safo Markoja ishte një grua me kulturë dhe piktoreshë rrallë. Për të dhe për bashkëshortin e saj, Petro Markon, do të shkruaj kujtimet e mia më vonë.)

E bëra këtë parashtesë për të kuptuar se sa i madh dhe i dashur ishte Sejfulla Malëshova dhe sa i izoluar mbeti ai nga populli, sepse diktatura ia kishte frikën si lakuriqi i natës nga qiriri me dritë.

Ky kolos i kulturës u flak në baltërat e Myzeqesë, aty ku edhe mbylli sytë më 17 qershor 1971. U sajua një shkak dhe u tha se ai vdiq nga apandisiti. U varros nga punonjësit e komunales, nga e motra dhe nga një mik i saj.

M’u kujtua biseda e Nasho Jorgaqit me Nolin, i cili e ftonte Nolin të kthehej në Shqipëri, se vendi kishte nevojë për mendimtarë të tillë. Por Noli u përgjigj: “Ju (Shqipëria) nuk keni nevojë për mendimtarë, se mendimtarët atje i keni, por i keni shpënë në baltërat e Myzeqesë.”

Kështu mbaroi në tragjedi jeta e Sejfulla Malëshovës, e këtij mendimtari poliedrik të kulturës shqiptare.

Vetëm kur erdhi demokracia u vlerësua ashtu si e meritonte. Iu rindërtua varri dhe u zhvillua një ceremoni me nderime për jetën dhe aktivitetin e tij. Por mendoj se aq sa janë bërë për të janë pak. Do të ishte mirë t’i bëhej një monument në Këlcyrë ose në Përmet dhe emri i tij t’i vihej një universiteti, p.sh. Universitetit të Gjirokastrës, por edhe ndonjë rrugë, kur dihet që rrugëve në Shqipëri u vihen emra të individëve që nuk janë shquar apo të njerëzve të huaj, ashtu si ka ndodhur në Kamzë. Në fushën e krijimtarisë letrare duhet bërë një studim më i thellë edhe për veprimtarinë e tij në Rusi, St. Petërburg, në Moskë si dhe për kohën e tij si mësues në Tashkent.

Ky mendimtar duhet vlerësuar për veprën dhe mendimin e tij demokratik dhe lirinë e njeriut.



OMBRA GVG boton librin e shkrimtarit të mirënjohur maltez

“JUTA HAJM”

nga Immanuel Mifsud

Romani përqendrohet rreth një aktori maltez, Erik Kseri, i cili është një personazh i famshëm i teatrit dhe televizionit. Ai është një person i egocentrik dhe feminist, i cili në mars të vitit 1980 vizitoi Gjermaninë. Gjatë vizitës së tij në Berlinin Lindor, ai kalon një natë me një kameriere të quajtur Jutta Hajm. Edhe pas kthimit të tij në Maltë, ai nuk arrin ta harrojë atë. Pasi gruaja e divorcon duke e i lënë edhe vajzën e tyre të vogël, në jetën e Erikut kalojnë edhe shumë gra të tjera me të cilat ka marrëdhënie afatshkurtra, por në të njëjtën kohë, ai vazhdon dhe mendon vazhdimisht për Jutta Hajmin, të cilës i dërgon letra të njëpasnjëshme përgjatë viteve por pa marrë asnjëherë përgjigje prej saj.

Tani është viti 2013, disa nga gratë me të cilat ka qenë i lidhur gjatë jetës së tij kanë ndërruar jetë, vajza e tij është martuar, dhe ai tani po jeton me një grua shumë më të re se vetja. Pas një para infarkti shëndeti i tij përkeqësohet dhe ai vendos të bëjë një përpjekje përfundimtare për të takuar Jutta Hajm duke u rikthyer sërish në Berlin kundër këshillave të mjekëve. Në një moment ai fillon të dyshojë se mbase Stasi e kishte zhdukur atë për shkak të marrëdhënies me të, ose ndoshta ajo mund të ketë qenë një spiune e vetë Stasi-t, ose mund të ketë pasur një fëmijë prej tij pas asaj nate që kishin kaluar bashkë. Kur shkon tek e njëjta adresë ku ai kishte kaluar atë natë me të dhe ku kishte dërguar letra për më shumë se njëzet vjet, e përshëndet një grua në moshë, e cila i thotë që ajo nuk ishte Jutta Hajm, dhe nuk kishte takuar kurrë më parë ndonjë grua të quajtur Jutta Hajm, dhe se ajo nuk kishte marrë asnjëherë ndonjë letër nga Malta. Duke menduar rreth dyshimeve që kishte rreth përfshirjes së Stasi-t në historinë e tyre, Erik Kseri shkon në arkivat e Stasi-t në Berlin për të kontrolluar nëse ekziston një dosje rreth tij apo Jutta Hajmit, por nuk rezulton asnjë e dhënë për të apo për këtë grua.

Zemërvrarrë, Erik Kseri kthehet në Maltë, por

pëson një atak fatal në zemër menjëherë pas kthimit të tij.

Në vitin 2014 është vlerësuar me *National Award for Prose* për librin “Jutta Hajm”.

Immanuel Mifsud ka lindur në Maltë më 12 shtator 1967. Ai ka filluar të shkruajë poezi dhe prozë qëkur ishte 16 vjeç, si dhe filloi të punojë me grupe eksperimentale teatrale, duke drejtuar vetë shfaqjet e tij dhe më vonë vuri në skenë vepra nga Chekhov, Dario Fo, Max Frisch, Federico Garcia Lorca, David Mamet, Harold Pinter dhe Alfred Buttigieg. Një sërë veprash të ndryshme të Immanuel Mifsud janë përkthyer dhe botuar në shumë vende evropiane dhe në SHBA gjithashtu.

Proza e Mifsudit tërhoqi menjëherë vëmendjen e kritikëve maltezë dhe fitoi etiketimin si shkrimtari maltez i gjeneratës X.

Ai ka shkruar gjashtë përmbledhje me tregime të shkurtra, gjashtë përmbledhje me poezi. Immanuel Mifsud shkruan edhe tregime për fëmijë, pasi ka botuar një përmbledhje me tregime të shkurtra për fëmijë si dhe një libër me ninulla. Ai ka marrë pjesë shumë festivale prestigjioze të letërsisë.

Në vitin 2011, ai u bë shkrimtari i parë maltez që fitoi çmimin prestigjioz *European Union Prize for Literature*.

Në vitin 2014, ai u emërua anëtar i Urdhrit të Meritës së Republikës së Maltës.

Mifsud u bë shkrimtari i parë maltez që u prit në Bibliotekën e Kongresit, në Uashington D.C., ku më 16 shkurt 2017, referoi dhe u intervistua gjatë një ngjarje të veçantë. Në të njëjtin vit ai u ngarkua të shkruajë një poezi për *Commonwealth Day*; Mifsud lexoi “Libri” gjatë festimit të *Commonwealth Day* në *Westminster Abbey* më 13 mars.

Mifsud ka studiuar në Universitetin e Maltës ku iu dha një doktoratë në letërsi në vitin 2012. Ai jep letërsi dhe teori letrare në të njëjtin universitet.

Ndër çmimet që shkrimtari i talentuar maltez Immanuel Mifsud ka marrë gjatë karrierës së tij janë:

- Fitues i *National Literary Award*, 2015 me librin *Jutta Heim*
- Fitues i *National Literary Award*, 2014 me librin *Penelopi Tistenna*
- Fitues i *European Union Prize for Literature*, 2011 për *Fl-Isem tal-Missier (tal-iben)*
- Është renditur në shortlist për *Premio Strega Europa*, 2008 për *L-Istejjer Strambi ta' Sara Sue Sammut*
- Ka marrë vendin e 2-të *National Literary Award*, 2005 për *Kimika*
- Fitues i *National Literary Award*, 2002 për *L-Istejjer Strambi ta' Sara Sue Sammut*
- Fitues i vendit të 2-të *National Literary Award*, 2001 për *Il-Ktieb tar-Rih u l-Fjuri*

SHPALLET LISTA E GJATË E MAN BOOKER PRIZE INTERNATIONAL 2020

13 libra të përkthyer nga tetë gjuhë janë përzgjedhur në listën e gjatë të Interantional Booker Prize.

Me synimin për të nxitur botimin dhe leximin e romaneve të huaj, është krijuar ‘International Booker Dozen’ si alternativa e të huajve për Booker Prize, ku vlerësohen ata libra që janë përkthyer në anglisht dhe janë botuar në Mbretërinë e Bashkuar ose Irlandë.

Shkrimtari dhe përkthyesi fitues do të ndajnë një shpërblim prej £50,000 dhe secili prej librave në listën e shkurtër (e cila do të shpallet në datën 2 prill) do të marrë një shpërblim prej £1,000 për shkrimtarin dhe përkthyesin.

Në listën e gjatë të këtij viti është e përfshirë shkrimtarja Samanta Schweblin nga Argjentina, autorja e librit *Sy të vegjël*, e cila më parë ka qenë në listën e gjatë për librin *Zogj në gojë* dhe në listën e shkurtër për *Largësi shpëtimi*, të International Booker Prize.

Lista e gjatë për International Booker Prize 2020

- Red Dog* nga Willem Anker (gjuhë afrikane – Afrika e Jugut), përkthyer nga Michiel Heyns
- The Enlightenment of The Greengage Tree* nga Shokoofeh Azar (farsi – Iran), me një përkthyes anonim
- The Adventures of China Iron* nga Gabriela Cabezón Cámara (spanjisht – Argjentinë), përkthyer nga Iona Macintyre and Fiona Mackintosh
- The Other Name: Septology I – II* nga Jon Fosse (norvegjisht – Norvegji), përkthyer nga Damion Searls
- The Eighth Life* nga Nino Haratischvili (gjermanisht – Gjeorgji), përkthyer nga Charlotte Collins and Ruth Martin
- Serotonin* nga Michel Houellebecq (frëngjisht – Francë), përkthyer nga Shaun Whiteside
- Tyll* nga Daniel Kehlmann (gjermanisht – Gjermani), përkthyer nga Ross Benjamin
- Hurricane Season* nga Fernanda Melchor (spanjisht – Meksikë), përkthyer nga Sophie Hughes
- The Memory Police* nga Yoko Ogawa (japonisht – Japoni), përkthyer nga Stephen Snyder
- Faces on the Tip of My Tongue* nga Emmanuelle Pagano (frëngjisht – Francë), përkthyer nga Sophie Lewis dhe Jennifer Higgins
- Little Eyes* nga Samanta Schweblin (spanjisht – Argjentinë), përkthyer nga Megan McDowell
- The Discomfort of Evening* nga Marieke Lucas Rijneveld (holandisht – Holandë), përkthyer nga Michele Hutchison
- Mac and His Problem* nga Enrique Vila-Matas (spanjisht – Spanjë), përkthyer nga Margaret Jull Costa and Sophie Hughes



AURA KRIPTO-TEOLOGJIKE E TRUPIT POLITIK

nga Gëzim Qëndro

Fragment nga libri



“Një vepër e hapur – thotë Umberto Eco – është [një fushë mundësish], nëse do të përdornim një koncept veçanërisht zbulues të kulturës bashkëkohore: konceptin e “fushës” [...] i cili përmban një vegim të ripërtërirë të marrëdhënieve klasike (njëkuptimëshe dhe të pakthyeshme) të shkakut dhe pasojës, i cili zëvendësohet nga një sistem forcash ndërsjellëse, një konstelacion ngjarjesh, një dinamizëm strukturash[...]”¹

Një fushë të tillë mundësish duket se e gjejmë në tablonë *Vizitë në plagë* të Enkelejd Zonjës (fig. 1) e cila të befason pikërisht me shtresëzimet e shumëfishta kuptimore të subjektit dhe dinamizmin e strukturave që shoqërohen nga loja metagjuhësore tipike postmoderne, ironia dhe paradoksi. Në historinë e pikturës shqiptare janë të pakta tablo të tilla të ngarkuara cit me simbole dhe idhuj, paradigma dhe fantazma të historisë.

Edhe nëse nuk e njeh veprën e Caravaggios *Shën Thomai mosbesues* (fig. 2) mjafton vetëm shenja në brinjën e Enverit e lënë nga shtiza e ndonjë Longinusi² modern, për të kuptuar se ai po sillet sikur të ishte ringjallur vërtet pas ndonjë kryqëzimi hipotetik. Ai u është shfaqur papritur, si njëfarë shajnie befasuese, tre shqiptarëve gati tridhjetë vjet pas vdekjes, duke u kërkuar (ashtu si Krishti shën Thomait) *“të mos jenë mosbesues, por besues”*³ se është ringjallur vërtet.

Pastaj, përpara tablosë së varur në mur zbulojmë me çudi praninë e një burri të ulur me shpinë nga tabloja, që rri krejt shpërfillës ndaj vizitorëve që sillen rrotull tij dhe shpejt vërejmë se nga pamja dhe veshja ngjan krejt me “shën Thomain” që shihet në tablo duke vënë gishtin tregues në plagën e Enverit. Cili është dhe ç’kuptim ka paraqitja e tij e njëkohshme në tablo dhe ulur para saj? Po ai djali mospërfillës me flokët punk që mban një Coca-Cola në dorë mos është vetë autori? Ç’lidhje ka me subjektin biblik ai burri i thinjur që kalamendet si i përhënur aty në fund pa marrë vesh ç’po ndodh? Ç’domethënie ka prania e tyre në tablo? Këto dhe plot pyetje të tjera na bëjnë të kthejmë kokë ndërsa qëndrojmë përpara kësaj tabloje befasuese. Përballja e detyruar me historinë dhe imperativin për të dhënë doemos një gjykim, na ndërgjegjëson se ndodhemi përpara një veprë politikisht provokuese dhe ideologjikisht (të paktën në fillim) të pakuptimtë.

Pastaj habisë së fillimit ia lë vendin një dell shpotitës: hem, edhe këtë kishim mangët, të shihnim në vendin e Krishtit, Enver Hoxhën, Zotmohuesin më të famshëm të historisë së shqiptarëve, hartuesin e kushtetutës së parë ateiste! Ndërkohë që shumica e shqiptarëve e mendojnë në Ferr, ai u shfaqet si i zgjedhuri i Parajsës ku, pas kësaj epifanie të fundit, do të ngjitet përgjithmonë

atje lart, mes të lumnuemve, vend që meritohet pas një jete të panjollë, të shënuar nga mirësia dhe mëshira e krishterë.

Nuk janë të paktë ata që përpara kësaj tabloje mund të mendojnë se liria artistike duhet ta ketë një cak, pasi

biblike, të cilën ata, si komunistë të bindur, e shohin si trillim të shkruar bukur dhe aq, ku mbase tek – tuk gjen ndonjë shkëndijë urtësie, por të vërteta, asnjë. Ndërsa fenë, mbështetur në besimin e patundur, në vërtetësinë e marksizëm-leninizmit fitimtar dhe mësimëve të Partisë dhe shokut Enver, e shohin si përçuese të obskurantizmit mesjetar dhe përligjëse të shfrytëzimit shekullor klasor. Për ta, institucionet fetare ishin rrjeti që shpërndante haptas “opium për popullin” dhe si të tilla meritonin të mbylleshin.

Të tjerët, shumica mospërfillëse, ateistë apo agnostikë, pjesë e traditës liberale që e shohin njohjen e Biblës si pjesë të formimit të tyre kulturor, në përballje me tablonë, fillimisht zbaviten: Pa shih ku i ka vajtur mendja, Enveri i ringjallur pas kryqëzimit! E megjithatë, ndërsa kundrojmë tablonë na shoqëron njëfarë sikleti. Në rastin më të mirë na duket një trill, një shaka, madje pa kripë që ideatori i ciklonit antifetar të 1967-ës, përndjekësi i klerit dhe shkatërruesi i institucioneve fetare të luajë role të cilat sa ishte gjallë nuk i luajti kurrë.

Por pasi ndërmendim të gjitha këto ndjejmë se tabloja kokëfortësisht refuzon luksin e shpjegimeve të thjeshta. Ajo na sfidon haptas ose të përballemi me paradoksin dhe lojën e saj metagjuhësore, ose të largohemi. A thua subjekti i pazakontë i tablosë të ketë ndonjë arsye më të thellë?

Kureshtar e pyeta Enkelejdin se si mbërriti te ky subjekt kaq i pazakontë. (Për të njëjtën arsye Sokrati dymijë e pesëqind vjet më parë u drejtoi piktorëve athinas të njëjtën pyetje). Edhe Enkelejdi, ndonëse nuk ngriti supet si kolegët e tij të lashtë, s’arriti të japë ndonjë përgjigje bindëse. Vendndodhja paradokohe e studios së tij pranë vilës së Enverit apo dhurimi nga dikush i një katalogu me vepra të Caravaggio-s vështirë se mund të pranohen si arsye të qenësishme. Në fund u binda se i kisha kërkuar diçka të pamundur. Problemi nuk qëndronte te piktori, por te kureshtja ime e pavend. Tek e fundit, përse duhej ta dinte, madje, si mund ta dinte autori nga ç’thellësi të

errëta të nënvetëdijes së tij ish ngjitur deri në sipërfaqen e vetëdijes subjekti i asaj tabloje?

(Pjesë nga hyrja e librit)



Fig. 1. Enkelejd Zonja, *Vizitë në plagë*, bojë vaji mbi pëlhurë, 2010.



Fig. 2. Caravaggio, *Shën Thomai mosbesues*, bojë vaji mbi pëlhurë, 1601-2.

kjo piktorë acaron shumëkënd. Besimtarët, për shembull. Kush e pa hapësirën e bulevardit *Dëshmorët e Kombit* të mbushur me portretet e klerikëve të pushkatuar nga regjimi i tij ateist, pa përmendur të burgosurit, të internuarit që vuajtën asokohe dënime të ndryshme për shkak të besimit, e kupton se kjo tablo nuk duhet shfaqur në publik pasi është një pakujdesi. Piktori duhej ta kish menduar dy herë përpara se ta tregonte Enverin në një rol që historia nuk ia njeh aspak.

Të pezmatuar ndihen me siguri edhe adhuruesit fanatikë të Komandantit. Ç’punë ka idhulli i tyre, kampion i njohur i ateizmit, me subjektin e një rrëfenje

1 Umberto Eco, *L'œuvre ouverte*, 2003, Éditions du Seuil, Paris, f. 29-30.

2 Longinus: me këtë emër njihet, sidomos gjatë Mesjetës, centurioni romak që goditi me ushtë brinjën e Krishtit të vdekur prej nga rrodhi gjaku i Tij. Në traditën e krishterë besohet se më pas Longinusi nga pagan u pagëzua i krishterë pasi shpalli më parë bindjen se Ai (Krishti) ishte vërtet biri i Zotit. Sot pranohet si njëri nga shenjtorët e Kishës.

3 Gjoni 20:27-28:

SHIJE TË NDRYSHME NË LETËRSI

nga C.S. Lewis

Jam menduar gjatë për problemin shqetësues të pikpamjeve të ndryshme për atë që quhet “shije” në letërsi, ndonëse kuptimet e fjalës “shije”, nëse shqyrtohen seriozisht, shmangin çdo lloj problemi. Nëse mendojmë se të zgjedhësh midis shkrimtares britanike të romancave, Ruby M. Ayres-it dhe Tolstojt është si të zgjedhësh midis birrës së butë dhe të fortë, atëherë kot të diskutosh, ose diskutimi s’do të ishte serioz. Por, nuk mendoj kështu. Këtë mund ta themi, në kulmin e një debati, por s’është argument i besueshëm as për atë që e thotë. Ideja që disa parapëlqime në art janë vërtetë më të mira se të tjerat s’mund të shmanget dhe meqenëse s’kemi një test objektiv për ta përcaktuar, problemi vetvetiu krijohet.

Pa menduar se problemi zgjidhet në një shkrim, e kam pyetur veten seriozisht, nëse s’jemi ne që e bëjmë të vështirë problemin, madje në mënyrë të panevojshme ngaqë që në fillim bëjmë një pohim të gabuar. Duhet thënë dhe rithënë se shkrimtari hamendëson se disa njerëz e pëlqejnë artin e dobët në po të njëjtën mënyrë si të tjerët pëlqejnë artin e mirë. Këtë e vë në dyshim. Unë parashtoj argumentin se arti i dobët, në një kuptim, s’ka asnjëherë sukses me asnjë lexues.

Së pari duhet të shpjegoj se çfarë është për mua arti i dobët. Nëse me artin e dobët ju nënkuptoni, le të themi, këngët epike të Nibelungëve, poemën epike të Walter Scott-it, “Marmionët”, atëherë s’diskutohet që teoria që të do shtjelloj këtu nuk funksionon. Duhet ta ulni standartin për art të dobët shumë më shumë se kaq. Me art të dobët ndoshta nënkuptoni krijimet letrare që s’janë parë si të denja për t’u marrë parasysh nga ata që i diskutojnë seriozisht çështje të tilla, por nga ana tjetër i dëgjon vazhdimisht në radio, bibliotekat jan përplot me to dhe madje reklamohen edhe në muret hoteleve. Pohimi i gabuar që po hedh poshtë është ai sipas të cilit këto krijime pëlqehen nga disa njerëz, po aq sa pëlqehet arti i mirë nga të tjerët, siç ndodh me poezitë e Ella Wheeler Wilcox-it ose me hitin më të fundit popullor në muzikë. Të tilla janë edhe disa lloje posterash por as që bëhet fjalë t’i përfshij.

Sigurisht, s’ka dyshim se këto gjëra pëlqehen në një farë mënyre. Transmetimet radiofonike vijnë, romanet qarkullojnë, librat poetik blihen. Por a kemi prova që ato zënë në jetën e dikujt vendin që zë arti i mirë në jetën e atyre që e duan atë? Shikojeni me vëmendje njeriun që shijon muzikë të keqe. Oreksi i tij është vërtet i madh. Është i gatshëm ta dëgjojë muzikën e parapëlqyer me dhjetëra herë në ditë. Por ai jo domosdoshmërisht e ndalon muzikën ndërsa flet me të tjerët. Ai flet dhe dëgjon. Fishkëllen, imiton ritmin duke tundur shputat e këmbëve, vallëzon nëpër dhomë, pi një cigare në tarracë ose tund një shkop sikur të ishte i dirigjentit. Dhe kur të mbaroj muzika, ose edhe para se të mbaroj, do t’ju flasë për diçka tjetër. Them kur muzika që po dëgjon ka mbaruar, kur ka “mbaruar” në një kuptim tjetër, kur ajo këngë ose valle ka dalë jashtë modës, ai kurrë s’mendon më për të dhe në mendoftë ndoshta e bën thjesht nga kureshtja.

Në letërsi, veçoritë e “konsumatorit” të artit të dobët janë edhe më të thjeshta për t’u përcaktuar. Ai (ose ajo) mund të dëshirojë kaq shumë të ketë racionin e përjavshëm të letërsisë së dobët, dhe mund të ndjehet fatkeq nëse kjo i mohohet. Por nuk rilexon kurrë. S’ka dallim më të qartë midis letrares dhe nën-letrares. Ky është dallim i pagabueshëm. Arti i mirë letrar rilexohet, arti i dobët letrar thjesht lexohet. Një roman i sapolexuar është për ta si gazeta që lexuan dje. Edhe mund të kesh pak shpresë për dikë që s’ka lexuar kurrë Odisenë, Malory-in, Boswell-in, apo Pickwick-un: por s’ka fare (për sa i përket letërsisë) për dikë që ju thotë se i ka lexuar dhe me kaq leximi ka përfunduar një herë e përgjithmonë. Është një lloj sikur një burrë të thoshte se është larë një herë, ka fjetur një herë, e ka puthur një herë gruan, ose se dikur ka bërë një shëtitje. Nëse poezia e dobët rilexohet apo jo (pesha e rëndesës së saj anon në mënyrë të dyshimtë nga dhoma e gjumit) s’e di. Por vetë fakti që s’e dimë është domethënës. Dhe kjo poezi nuk bëhet pjesë e bisedës së atyre që e blejnë librin. Askush s’i dëgjon dy të dashuruar duke cituar vargje apo duke bërë një bisedë të këndshme në muzg për librin e parapëlqyer. Kështu ndodh edhe me pikturën e dobët. Blerësi tregon sinjerisht, pa dyshim, se për të është pikturë e mirë, me ngjyra të ngrohta, e bukur, tërheqëse, ose (me shumë mundësi) thjesht “e këndshme”. Por ai e var aty ku s’mund të shihet dhe s’ia hedh më sytë.

Në gjithë këtë, sigurisht, gjejmë shenjat e një dëshire të vërtetë për artin e dobët, por një dëshirë që s’është e njëjtë me dëshirën e njeriut për art të mirë. Ajo që dukshëm dëshirojnë dhe marrin klientët e përhershëm të artit të dobët është një mjedis i bukur ku lulëzon jeta, diçka për të mbushur çaste të çuditshme, “pako për bagazhin mendor ose “ushqim të fortë” për stomakun mendor. Në të vërtetë s’bëhet fjalë për çështjen e lumturisë, për përvojë si ajo e prerjes nga tehu i briksut të rrojës, e cila e ribën tërësisht mendjen, dhe shkakton “dridhjen e shenjtë”, duke e formësuar një njeri të ndjehet “vërtet i sëmure, ashtu siç kam qenë kur dashuroja gruan” siç përshkruhet në ditarët e Samuel Pepys-it. Kënaqësia që merret nga arti i dobët s’është dukuri e cila ndodh në një kontekst të pafat, e njëjtë me kënaqësinë që njeriu merr nga arti i mirë. Dëshira për artin e dobët është dëshirë e lindur nga zakoni, ashtu si dëshira e duhanpirësit për duhan, më shumë e karakterizuar nga gjendje e skajshme e gjendjes së sëmure se sa nga ndonjë kënaqësi shumë e fortë në përmbushjen e nevojës.

Prandaj, përvojat e para të një gëzimi të vërtetë në arte nuk u shfaqën si përvoja kundërshtare me kënaqësitë e mëparshme të mërztishme. Kur isha djalos, nga leximi i “Poema të Romës antike” të Thomas Babington Macaulay-t (jo të dobëta sa duhet për të shpjeguar çfarë po argumentoj) tek leximi i poemës së Matthew Arnold-it “Sohrabi dhe Rustumi”, s’e kisha fare ndjesinë se po merrja më shumë kënaqësi në aspektin sasior apo cilësor nga sa kisha marrë më parë. Ishte më shumë sikur një dollap rrobash, të cilin deri atëherë e kishe parë si një vend ku vareshin teshat, një ditë bëshesh dëshmitar se pasi të hapësh derën, të çon në kopshtin mitologjik të nimfave Hesperides, ashtu si një ushqim që e ke pëlqyer për shijen që ka, një ditë të bën të mundur (si gjaku i dragoit) që të kuptosh këngët e zogjve, ashtu si uji, i cili përveç shuarjes së etjes, befasisht shndërrohet në pije dehëse. Është sikur të zbulosh se dukuria e vjetër, e njohur si “poezi” mund të përdoret, për një qëllim krejtësisht të ri. Shndërime të tilla thjesht interpretohen gabim duke thënë se “djalit ka filluar t’i pëlqejë poezia”, ose “ka filluar t’i pëlqejë poezia e mirë”. Ajo që ndodh është se diçka që ka mbetur në sfond si një prej kënaqësive të vogla të jetës, jo krejtësisht e ndryshme nga kafeja, brof përpara teje dhe të mbështjell aq fort sa je “vërtet i sëmure”, derisa të rrënqethesh, të ndjesh zjarrin dhe ftohtësinë e acartë të ndjenjave, mus si një dashnor.



Kësisoj, dyshoj se s'duhet të themi se thjesht disave u pëlqen arti i mirë dhe disave arti i dobët. Gabimi këtu fshihet tek folja “pëlqej”. Ndoshta mund të thoni se në frëngjisht fjala “aimer” përdoret për të thënë se një burrë “do” një grua ashtu si “do” golfin dhe mund të provoni t'i krahasoni këto dy “dashuri” për sa i përket “shijes” më të mirë dhe më të keqe. Jemi bërë kështu viktima të një loje fjalësh. Pohimi i duhur është se disa e pëlqejnë artin e dobët, por arti i mirë shkakton një reagim për të cilën “pëlqimi” është fjala e gabuar. Dhe ky reagim, ndoshta, nuk shkaktohet kurrë nga arti i dobët.

Asnjëherë? A nuk ka libra që krijuan tek ne magjepsjen që kam përshkruar (në rini) dhe të cilën ne e gjykojmë si art të dobët? Ka dy përgjigje. Së pari, nëse teoria që po parashtrij funksionon në shumicën e rasteve, ia vlen të merret parasysh dhe të diskutohet nëse përjashtimet e dukshme mund të mos jenë vetëm të dukshme. Ndoshta çdo libër që i ka pëlqyer një lexuesi, sado i ri qoftë, ka ndonjë gjë të mirë në të.

Kam thënë më parë se arti i dobët nuk shijohet kurrë në të njëjtën kuptim si shijohet arti i mirë. Thjesht arti “i pëlqyer” asnjëherë nuk befason, nuk trondit, nuk të bën rob të tij. Tani, që e them këtë, na del përpara një vështirësi. Dhe kjo vështirësi s'është shpjeguar nga askush kaq mirë se sa nga artisti i shkëlqyer dhe i shpërfillur Forrest Reid. Në autobiografinë e titulluar “Apostate” ai përshkruan kënaqësinë që kishte marrë kur ishte djalos, gjatë leximit të librit “Ardath” me autore Marie Corelli-in. Edhe në atë moshë, pjesa e fundit i ishte dukur “aq e keqe sa dobësoi përshtypjen e asaj që kisha lexuar më parë”. Por përshtypja e mëhershme mbeti. Ndoshta me mençuri zoti Reid s'rrezikoi ta rilexonte librin kur ishte i rritur. Nuk e rilexoi prej frikës se “ajo që më kishte mrekulluar dikur me shumë gjasa do të më dukej krejt e rëndomtë, aventura e zjarrtë do të ngjante si melodramë, poezia si sforcim i pastërtholluar pas efektit të krijuar”. Por sidoqoftë, shton Reid, s'është fare e dobishme “të mëtoresh se kënaqësia e dikurshme s'ishte aspak kënaqësi estetike. Ishte. Kjo është e gjithë çështja”, dhe ai jep ndihmesën e tij me sugjerimin e rëndësishëm: “Ajo që lexova atëherë ishte “Ardath” e imagjinatës së zonjës Corelli. Ajo që duhej të lexoja tani do të ishte “Ardath” shumë më pak shkëlqim se sa arritja e saj e vërtetë letrare”.

Kjo diagnozë mund të mos jetë e saktë. Zoti Reid mund të ketë përvetësuar nga leximi Ardath-n e imagjinatës së autorit, ose mund ta ketë lexuar Ardath-in e vet, domethënë, mund të ketë shijuar një krijim fillestar të vetin nga nxitja e marrë nga libri. Por s'është e nevojshme të vendosësh midis këtyre dy mundësive. Çështja është se, nga ana tjetër, ai po e shijonte librin jo për atë që ishte, por për atë që nuk ishte. Dhe kjo lloj gjëje ndodh shumë shpesh kur lexuesi ka imagjinatë më të fuqishme se autori, sidomos kur është i ri dhe jo kritik ndaj asaj që lexon. Kështu, për një djallë imagjinatë e të cilit po njeh lulëzimin e parë, përshkrimi më i saktë i tablosë së një anijeje me vela mund të ketë ndikimin e nevojshëm. Në të vërtetë ai vështirë se e sheh anijen. Sakaq është një mijë milje larg, me ujën e kripur në buzë, me bashin që ngrihet e ulet në ujëra, ndërsa pulëbardhat shfaqen për të paralajmëruar se vendi i pazbuluar është afër.

Ajo që s'do ta pranoj është se kjo rrëzon, në përgjithësi, parimin që arti i dobët nuk e ngazëllen kurrë lexuesin. Mund të rrëzojë zbatimin e gatshëm të

këtij parimi si një njësi matëse. Aq më mirë. Ne duam të jemi të sigurt se ekziston një dallim i vërtetë midis artit të mirë dhe të dobët, dhe se zhvillimi i shijes s'përbën një luhatje pa vlerë. S'është kaq e nevojshme, madje mund të mos jetë jetë e përshtatshme, që ta dimë me siguri, në çdo rast të veçantë, kush është gabim dhe kush ka të drejtë. Ekzistenca e vegimeve (si ajo që, për zotin Reid, nuk erdhi si rrjedhojë, por u mbështet në fjalët e zonjushë Corelli-t) nuk e rrëzon parimin. Tek vegimi, kënaqemi me atë që nuk ekziston, atë që jemi duke krijuar për veten ose mund të ndodh, kënaqemi me atë që kujtojmë nga vepra të tjera dhe më të mira për të cilat vepra që po lexojmë bëhet shkas. Dhe kjo është diçka mëse e dallueshme nga masa e madhe e “pëlqimit” ose “vlerësimit” për artin e dobët. Klientët e poezisë sentimentale, romaneve të dobëta, pikturave të këqija dhe melodive thjesht tërheqëse zakonisht shijojnë pikërisht atë që ekziston tek ato. Dhe kënaqësia e tyre, nuk është në asnjë mënyrë e krahasueshme me kënaqësinë që të tjerët marrin nga arti i mirë.

Arti i dobët s'të magjeps, është i parëndësishëm, i padobishëm, i zakonshëm. As nuk i trazon dhe as nuk i



përndjek konsumatorët e tij. Ta quash edhe magjepsjen prej një tragjedie të madhe ose muzikë të elegante, me të njëjtin emër, “pëlqim”, është pak më shumë se lojë fjalësh. Ende mbroj pikëpamjen se arti që të magjeps dhe të mbart brenda tij është gjithmonë i mirë. Në vegime, kjo e mirë s'është aty ku hamendësojmë ne se është, pra, tek libri ose piktura. Por mund të jetë i mirë në vetvete, ashtu si një oaz është gjë e mirë megjithëse ekziston qindra milje larg porse s'është edhe aq larg nëse udhëtari e pikas në luginën përballë. Ende s'kemi prova se cilësitë e pranishme tek arti i dobët mund të bëjnë për këdo atë që bën arti i mirë për disa. Jo sepse arti i dobët jep kënaqësi, por sepse të jep kënaqësi të një lloji krejtësisht tjetër. Le të mos shmangemi nga kryesorja duke shtruar pyetjen nëse dallimi është midis kënaqësisë “estetike” dhe një lloji tjetër kënaqësie. Të dyja llojet e artit ndoshta japin kënaqësi estetike. Çështja është se askush s'i kushton vëmendje artit të dobët në të njëjtën mënyrë si disa i kushtojnë vëmendje artit të mirë.

Nëse është kështu, atëherë s'përballemi me përvoja

të kundërta në art midis të cilave duhet të zgjedhim që të formojmë ose jo “një shije të mirë” në nivelin që po diskutoj. Përtej këtij niveli, nëse zhdukim atë që pranohet të jetë art i dobët nga lexuesit që kanë njëfarë aftësie gjykimi kritik, mund të hasim problemin më të vështirë. Ju mund të vendosni që kompozitori francez Hektor Berlioz qëndron më poshtë se Bach-u ose Shelley kundrejt poetit Richard Crashaw. Por unë sugjeroj që çdo vepër e cila ka krijuar njëherë kënaqësi të madhe dhe dalldisëse për dikë – një vepër që ka pasur vërtet rëndësi, ajo ka hyrë brenda rrethit të unazës, dhe se shumica e asaj që ne e quajmë “art popullor” s'ka qenë kurrë kandidat për të hyrë brenda tij. As s'është përpjekur të hyjë aty, mbrojtësit e këtij lloji arti s'e kanë dashur një gjë të tillë, s'e kanë konceptuar artin e tyre për të hyrë brenda atij rrethi veprash dhe as nuk e kanë synuar.

Në këtë këndvështrim, kriteri i artit të mirë do të ishte thjesht empirik. Nuk ka një test të jashtëm por është kriter i pagabueshëm. Madje unë do të shkoja më tej. Do të sugjeroja që aftësitë më të mprehta dalluese kritike për ato vepra që janë vetëm brenda rrethit të unazës, përfshijnë gjithmonë (dhe me të drejtë) më shumë se sa kriterin estetik. Kështu ju më thoni se ajo që përjetova kur dëgjova për herë të parë preludin e operas “Parsifal” të Wagnerit qëndron më poshtë se përvoja në dëgjimin e kompozimeve “Muzika e pasionit” të Bach-ut. Jam i sigurt që keni të drejtë. Por s'mendoj se doni të thoni, ose nënkuptoni që arti i Wagnerit është i dobët në kuptimin që muzika shumë popullore është art i dobët. Arti i tij është brenda rrethit të unazës. Meloditë e komedive muzikore, të cilat i këndoja nën zë kur isha djalos, nuk vlerësoheshin nga unë në të njëjtën mënyrë si vlerësoja “Parsifal-in”. Asnjëherë s'ka pasur qoftë edhe një mundësi që ato të konkuronin me njëra-tjetrën. Dhe kur ju e quani artin e Wagnerit “të dobët” (në një kuptim shumë më të lartë dhe më të stërholluar) gjithmonë keni parasysh aspekte që janë teknike ose morale të cilat, në qarqe artistike, shpesh maskohen nga ata që i përdorin. Kështu e dënioni Wagnerin si banal, ose si shumë të qartë, sipërfaqësor (të cilat janë aspekte teknike), ose si vulgar, sensual, apo barbar (të cilat janë aspekte morale). Mendoj se mënyra e gjykimit është e drejtë. Vetëm se asnjë prej këtyre kriterëve s'është e nevojshme, ose s'është përdorur për të bërë dallimin paraprak midis artit “real” ose “të mirë” apo “serioz” dhe artit që padyshim është “i dobët” ose (thjesht) “art popullor”. Ky kriter s'ka qenë kurrë konkruet. Wagneri është “i mirë” për shkak se mund të bëhet gjëja më e rëndësishme në jetë për një djallë për një vit të tërë ose më shumë. Pas kësaj, vendosni si të dëshironi. “E mira” e këtij arti në kuptimin që po them unë ekziston.

Disa nga këta që hutohen e ngatërrohen s'e kuptojnë dot se si një aksiomë (le të themi, për gjërat që janë barasvlerëse të së njëjtës gjë) mund të pranohet se është e vërtetë. S'do të mund të ishte e tillë nëse për të do të gjendej një pohim të ndërkëmbyeshëm. Por s'ka ndonjë pohim tjetër: ekziston një fjalë e cila duket (gramatikisht) si pohim, por s'është e tillë, sepse nëse e shqipton, asgjë s'ndodh në mendjen tënde. Në të njëjtën mënyrë, s'ka asnjë përvojë tjetër si ajo që krijon arti i mirë. Përvoja e krijuar nga arti i dobët nuk është e njëjtë.

Përktheu: Granit Zela

Gëzim Qëndro

AURA KRIPTO-TEOLOGJIKE E TRUPIT POLITIK

THE CRYPTO-THEOLOGICAL AURA
OF THE POLITICAL BODY



Onufri